



Praktikat Premtuese të ngritjes dhe ofrimit të shërbimeve të mbështetjes së specializuar për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale

Një panoramë ligjore dhe praktike për OJF-të e grave dhe politikëbërërsit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

Përbledhje Ekzekutive



Ky program financohet nga Bashkimi Evropian





GRATĒ
KUNDĒR
DHUNĒS
EVROPĒ

Rrjeti i Grave Kundër Dhunës Evropë (WAVE) është një rrjet mbarë evropian prej më shumë se 160 anëtarësh (përfshirë OJF të grave, rrjete OJF-sh dhe anëtarë individualë) në 46 vende evropiane, që janë të përkushtuar të trajtojnë dhe parandalojnë dhunën kundër grave dhe vajzave. Që prej themelimit në vitin 1994, WAVE ka punuar për promovimin dhe forcimin e të drejtave të grave dhe fëmijëve, dhe për t'i mundësuar grave dhe fëmijëve të jetojnë pa dhunë, veçanërisht përmes ngritjes dhe mirëmbajtjes së një rrjeti të fuqishëm evropian shërbimësh të specializuara mbështetëse, ekspertësh dhe të mbijetuarish.

EKIPI

Drejtuese e Ekipit të WAVE Anca Ciupa

Konsulentët Biljana Brankovic, Konsulente Ndërkontaktare e Këshillit të Evropës¹, Serbi
Cliona Saidléar, Drejtore e Rrjetit të Krizës së Përdhunimit, Irlandë

Partnerët e Platformës për Forcimin e Shoqërisë Civile (CSSP)

Shqipëri Mirela Arqimandriti (Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim)

Bosnje dhe Hercegovinë Aleksandra Petrić (Fondacioni Gratë e Bashkuara Banja Luka)

Kosovë* Ardit Ramizi Bala (Qendra e Mirëgenies së Grave) Mali i

Zi Jovana Vujacic (Linja SOS për Gratë dhe Fëmijët
Viktima të Dhunës - Nikshiq)

Maqedonia e Veriut Elena Dimushevska (Rrjeti Kombëtar për Eliminimin e DHKG dhe DHF – Zëri kundër dhunës)

Serbi Marija Petronijević (Shogata Fenomena)

Turqia: Nihan Damarli (Fondacioni për Solidaritet me Gratë)

Dizajni Grafik Monika Medvev

Selia e Rrjetit WAVE Bacherplatz 10 / 6, 1050 Vienë, Austria
www.wave-network.orgcssplatform.org

Data e Botimit Gusht 2021

Ky botim u bë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e WAVE dhe nuk pasavron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bordit të vet Ekzekutiv, apo Vendeve Anëtare të Kombeve të Bashkuara. Përcaktimet në këtë botim nuk nënkoputojnë opinion lidhur me statusin ligjor të ndonjë vendi apo territori, ose të autoriteteve të tyre, apo lidhur me demarkim të kufijve përkatës. Teksti nuk është redaktuar sipas standardeve zyrtare të botimit dhe UN Women nuk mban përgaqësi për asnjë qabim.

1 Biljana Brankovic është gjithashtu anëtare e GREVIO-s. Megjithatë ajo është bashkëautore e këtij dokumente në cilësinë e saj personale si Konsulente dhe jo në cilësinë e saj si anëtare e GREVIO-s, kështu që opinionet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen GREVIO-s në përgjithësé.

* Për Bashkimin Evropian, ky përcaktim jetet pa paragjykim për qëndrimet mbi statusin, dhe në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 1244/1999, dhe Opinionin e GjND-së lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Për UN Women, referatcat që lidhen me Kosovën duhet të kuptohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999).

Praktikat Premtuese të ngritjes dhe ofrimit të shërbimeve të mbështetjes së specializuar për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale

Një panoramë ligjore dhe praktike për OJF-të e grave dhe politikëbërërsit në **Ballkanin Perëndimor dhe Turqi**

Përbledhje Ekzekutive

PËRMBAJTJA

I.	<u>Hyrje</u>	4
II.	<u>Vlerësimi i nevojës së mundshme për mbështetje</u>	6
III.	<u>Krijimi i një gjuhe të përbashkët:</u> shërbimet e mbështetjes së specializuar për viktimat e dhunës seksuale	9
IV.	Parimet, konceptet dhe arsyetimi në bazë të <u>modelit të krizës së përdhunimit</u> 11	
V.	<u>Politikat Strategjike:</u> hapat drejt llogaridhënie së shtetit.....	14
VI.	<u>Dhuna dhe ngacmimi seksual</u> në ligj	16
VII.	<u>Vlerësimi i nevojave të të mbijetuarave:</u> rëndësia e të dhënave	17
VIII.	<u>Mbështetja për viktimat</u> e dhunës seksuale.....	19
IX.	<u>Protokollet ose udhëzuesit</u> që regullojnë detyrat e profesionistëve dhe procedurat në rastin e dhunës seksuale, përfshirë përdhunimin.....	21
X.	<u>Raportimi</u> nga profesionistët.....	24
XI.	Arsyetimi për <u>autonominë e OJF-ve të grave</u>	26
XII.	Fjalët përbyllëse dhe rekomandimet	27

I. Hyrje

Kjo Përbledhje Ekzekutive është hartuar në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të identifikuara në ‘Dokumentin e Politikave të CSSP-së: Praktikat premtuese të ngritjes dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale.

Një panoramë ligjore dhe praktike për OJF-të e grave dhe politikëbërësit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi’.

Dokumenti i Politikave dhe Përbledhja Ekzekutive janë hartuar si pjesë e projektit të BE-së/UN Women “Forcimi i kapaciteteve të rrjeteve të OSCH-ve rajonale për advokim politikash, zgjerim bazuar në njohuri dhe lehtësim partneriteti për dhunën seksuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, të zbatuar në kuadër të programit rajonal të BE-së/UN Women “Eliminimi i dhunës kundër grave: Zbatim i normave, ndryshim i mendësisë.” Programi synon t’i japë fund diskriminimit me bazë gjinore dhe dhunës kundër grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, përfshirë Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Serbinë dhe Turqinë.

Me qëllim trajtimin e gjetjeve¹ të raportit të hartëzimit të vitit 2019, projekti për Platformën për Forcimin e Shoqërisë Civile (CSSP) organizoi një trajnim për ngritje kapacitetesh me qëllim promovimin e standardeve të praktikës premtuese për mbështetjen e viktimate të dhunës seksuale, në kuadër të shërbimeve të specializuara të mbështetjes për gratë viktima të dhunës seksuale, të OJF-ve të tjera të grave dhe palëve të interesit si politikëbërësit. Synimi përfundimtari trajnimit ishte të përgatiste më mirë ofruesit e shërbimeve lidhur me mbështetjen efikase për viktimat e dhunës seksuale, si dhe të jepë kontribut për hartimin e këtij Dokumenti Politikash.

Synimi i këtij dokumenti është t’i ofrojë politikëbërësve kombëtarë dhe OJF-ve të grave një instrument të nxëni për ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për gratë dhe fëmijët viktima të dhunës seksuale, që në të ardhmen mund të informojnë kuadrin kombëtar të ofrimit të shërbimeve. Ai përqendrohet në theksimin e praktikave premtuese të zbatuara nga OJF-të e grave dhe palë të tjera interesit gjatë mbështetjes së grave viktima

të dhunës seksuale, dhe në krijimin e një gjuhe të përbashkët kur bëhet fjalë për shërbimet e specializuara të përmendura në Konventën e Stambollit, përkatësisht krizen e përdhunimit dhe qendrat e referimit të dhunës seksuale. Ky dokument skicon një proces të zgjerimit dhe të nxënët për OJF-të e grave dhe plotikëbërësit kombëtarë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, si dhe vlerëson nevojën për mbështetje të specializuar për viktimat e dhunës seksuale, duke çuar përparrë parimet, konceptet dhe arsyetimin në bazë të modelit të krizës së përdhunimit.

Ky dokument mbështetet pjesërisht në përvojën dhe standartet e krijuara në Irlandë. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet që OJF-të e grave në vend, veçanërisht qendrat e krizës së përdhunimit, kanë ofruar shërbime të specializuara kryesisht për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë seksuale për më shumë se 40 vjet.² Këto shërbime të ofruara në Irlandë, por edhe në MB pasqyrojnë standarde të larta mbështetjeje dhe përfaqësojnë kulmin e një procesi të gjatë kërkimi, reflektimi, konsultimi dhe përcaktimi, duke ofruar një qasje ndaj praktikës dhe ofrimit të informuar nga trauma, që është e përshtatshme dhe efikase gjatë mbështetjes së të mbijetuarve të të gjitha formave të dhunës seksuale.

Një element i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë është se në vitin 2021, Turqia është tërhequr nga Konventa e Stambollit³ me anë të një Dekreti Presidencial të botuar më 20 mars. Kështu, Turqia nuk ka më asnjë detyrim përfundimtari trajnimit të mbrohen në mënyrë të përshtatshme nga dhuna, çka kërkon angazhim politik serioz dhe të vazhdueshëm për mbrojtjen e grave në dhuna, veçanërisht nga dhuna seksuale. Kështu, gjatë trajtimit të situatës në Turqi në këtë dokument, WAVE vijon të rekomandojë zbatimin e standardeve të mëposhtme

Me rritjen e dhunës kundër grave dhe vajzave në nivele të reja në të gjithë botën si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, është me shumë rëndësi që gratë dhe fëmijët të mbrohen në mënyrë të përshtatshme nga dhuna, çka kërkon angazhim politik serioz dhe të vazhdueshëm për mbrojtjen e grave në dhuna, veçanërisht nga dhuna seksuale. Kështu, gjatë trajtimit të situatës në Turqi në këtë dokument, WAVE vijon të rekomandojë zbatimin e standardeve të mëposhtme

1 Vetëm tre nga shtatë vendet anëtare kanë identifikuar shërbime të specializuara për dhunën seksuale, të cilat shpesh zbatohen në mënyrë të dobët për shkak të mungesës së mbështetjes qeveritare dhe fondevë. Gjithashtu, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të OJF-ve të grave, ofruesve të shërbimeve dhe politikëbërësve lidhur me çështjen e dhunës seksuale janë të pamjaftueshme dhe nuk ka parime udhëzuese të mjaftueshme për mbështetjen e viktimate të dhunës seksuale nga shërbimet, çka sjell mungesë serioze besimi nga ana e viktimate lidhur me raportimin e këtyre krimive.

2 https://rapecrisis.org.uk/media/2162/rncss_partners_final.pdf; <https://www.solacewomensaid.org/>; <https://www.womensaid.org.uk/>

3 <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/turkey-s-announced-withdrawal-from-the-istanbul-convention-endangers-women-s-rights>

nga Turqia, kur synohet mbrojtja dhe mbështetja e viktimateve të dhunës seksuale.

Metodologjia dhe struktura e këtij dokumenti

Dokumenti i politikave u hartua me ndihmën e dy eksperteve ndërkombe të Biljana Brankovic,⁴ Konsulente Ndërkombe e Këshillit të Evropës dhe Anëtare e Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO)⁵ në Serbi, dhe Clíona Saidléal Drejtore e Rrjetit të Krizës së Përdhunimit në Irlandë. Në cilësinë e saj, Dr. Clíona Saidléal është përqendruar në ofrimin e një shpjegimi të detajuar të mbështetjes së specializuar për gratë viktima të dhunës seksuale, duke trajtuar elementet operacionale, parimet, konceptet dhe arsyetimin në bazë të modelit të krizës së përdhunimit në Irlandë, bazuar në përvojën e Rrjetit të Krizës së Përdhunimit në Irlandë. Biljana Brankovic ka dhënë kontributin e saj bazuar në një analizë bazë të situatës në të shtata vendet anëtare, si dhe të punës që është kryer më parë në rajon, si Raporti i Hartezimit i WAVE i vitit 2019, si dhe punës së OJF-ve të grave në rajon.

Analiza bazë e kryer në të shtata vendet partnere u bazuar në një pyetësori të hartuar paraprakisht nga Biljana Brankovic. Pyetësori iu dërgua partnerëve kombëtarë në të shtata vendet, për të siguruar që informacioni/të dhënët e mbledhura nga partnerët kombëtarë të bazohej në një metodologji të unifikuar dhe të lejonte krahasimin ndërmjet vendeve. Të nëntë partnerët CSSP siguruan informacion të detajuar në formatin e raporteve kombëtare. Bazuar në përgjigjet e tyre, analiza merr në shqyrtim ndër të tjera anketimet shumëvendëshe për praninë e dhunës seksuale; përvojën e mëparshme të OJF-ve të grave lidhur me asistencën për viktimat e dhunës seksuale, mangësitë e reagimit të drejtësisë penale ndaj përdhunimit dhe sulmit seksual (kur ishin të disponueshme); politikat strategjike në zbatim lidhur me problemin e dhunës seksuale, për shembull të gjitha planet kombëtare të veprimit që përfshijnë ose trajtojnë në mënyrë të veçantë dhunën seksuale; kriminalizimin e dhunës dhe ngacmimit seksual; çështjen nëse ekzaminimi mjeko-ligjor ose shërbime të tjera

mund të merren pavarësisht vullnetit të viktimateve për të raportuar. Segmente të raporteve të Monitorimit të GREVIO-s për mënyrën se si Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) është zbatuar në vendet anëtare, dhe që i referohen çështjes së dhunës seksuale, janë analizuar gjatë dokumentit në ato raste kur ato janë të disponueshme për vendet e veçanta.

Dokumenti përqendrohet kryesisht në standarde e mishëruara në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, përkatësisht në Nenin 25 të Konventës.⁶ Konventa e KiE thekson ndër të tjera, rëndësinë e ofrimit të mbështetjes së përshtatshme për gratë viktima të dhunës seksuale, në formën e qendrave të referimit të dhunës seksuale apo qendrat e krizës së përdhunimit. Për më tepër, rapporti shpjegues i konventës vëren se duke qenë se dhuna seksuale është veçanërisht traumatizuese, ajo kërkon përgjigje veçanërisht të ndjeshme nga staf i trajnuar dhe i specializuar. Kjo mbështetje mund të përfshijë ndër të tjera, kujdes të menjëherëshëm mjekësor, mbështetje për traumën, ekzaminime mjeko-ligjore, ofrimin e informacionit të përshtatshëm dhe udhëzimin me ndjeshmërinë përkatëse. Mund të përfshijë edhe shoqërim në shërbime të ndryshme shoqërore, ose në polici për të bërrë ankesë, ose edhe udhëzim në kuadër të çështjeve të mundshme ligjore, përfshirë këtu parandalimin e viktimidit për së dyti përmes vendimeve gjyqësore.⁷ ■

4 Biljana Brankovic ka punuar për këtë projekt në cilësinë e saj si individ, kështu që opinionet që ka shprehur në këtë dokument nuk mund ti atribuohen GREVIO-s si organizatë.

5 GREVIO është organi i pavarur i ekspertëve, që është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) nga Palët.

6 Sipas Nenit 25 "Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale" Palët marrin masat e nevojshme ligjore dhe të llojeve të tjera për të siguruar ngritjen e numrit të mjafueshëm të qendrave të përshtatshme dhe të aksesueshme lehtësisht të krizës së përdhunimit ose të referimit të dhunës seksuale për viktimat, të cilat ofrojnë ekzaminime mjekësore dhe mjeko-ligjore, mbështetje për traumën dhe këshillim për viktimat.

7 Këshilli i Evropës (2011). Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Raporti Shpjegues, botimet e Këshillit të Evropës, Strasburg, fq. 82

II. Vlerësimi i nevojës së mundshme për mbështetje

Me qëllim përcaktimin e nevojës së mundshme për ngritjen e shërbimeve të specializuara për mbështetjen e viktimate të dhunës në familje, duhet të vlerësohet paraprakisht nevoja e mundshme për mbështetje, dhe sa viktima të dhunës seksuale mund të kenë nevojë për mbështetje të tillë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ka kryer një studim në vitin 2018 për prevalencën⁸ e dhunës kundër grave në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi). Studimi shqyrtoi dhunën me të cilën përballen gratë, ndikimin e dhunës tek gratë dhe vajzat, përfshirë edhe pasojat afatgjata, si dhe sjelljen e të mbijetuarave sa i përket kërkesës për ndihmë.

Studimi u botua në vitin 2019, dhe thekson sa më poshtë:

- Prevalanca e dhunës seksuale gjatë gjithë jetës (përvojat e dhunës seksuale duke filluar nga mosha 15 vjeçare) nga një partner luhatej nga 5% në Serbi deri në 3% në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut
- Disa gra besojnë se janë të 'detyruara' të kenë marrëdhënieks seksuale në martesën e tyre;
- Shumë gra vuajnë nga pasojat psikologjike afatgjata të dhunës seksuale nga partneri i tyre aktual apo një person që nuk është partneri.
- Të mbijetuarat e dhunës seksuale nga persona që nuk janë partneri i tyre, kishin më shumë gjasa të zhvillonin simptoma të ankthit (55%) krahasuar me gratë që kishin vuajtur forma të dhunës fizike;
- Pothuajse gjysma e grave nuk e kanë diskutuar me askënd incidentin më serioz të ngacmimit seksual që kanë vuajtur, dhe asnjë grua nuk ka kontaktuar organizata të mbështetjes së viktimate;

- Shumica dërrmuese e grave që kanë vuajtur dhunë fizike dhe/ose seksuale kanë vendosur të mos raportojnë incidentet më serioze në polici, apo një institucion tjetër a organizatë;
- Raporti i viktimate që kanë kërkuar ndihmë nga organizata të mbështetjes së viktimate është më pak se 1%, që mund të vijë si pasojë e një sërë arsyesh, përfshirë mungesën e shërbimeve të specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës seksuale në rajon;
- Një numër i konsiderueshëm grash në Ballkanin Perëndimor mund të konsiderohen të prekura drejtpërsëdrejti nga konflikti në rajon, dhe ky raport është nga 10% në Malin e Zi deri në 770% në Kosovë, çka mund të tregojë se viktimat e luftës po 'fshihen' midis grave të rajonit.

Këto gjetje duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të mundësisë për ngritjen e shërbimeve të specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës seksuale. Nëse këto shërbime ngrihen, ato duhet të janë të specializuara dhe të përshtatura për të përmbrushur nevojat specifike të të mbijetuarave të abuzimit seksual.

Të dhënët për prevalencën dhe gjetjet mbi pasojat psikologjike të dhunës seksuale gjithashtu duket se nënkuptojnë se **gratë në Ballkanin Perëndimor mund të kenë nevojë më të madhe për qendra të krizës së përdhunimit**, se sa për qendra të referimtë dhunës seksuale, duke qenë se të parat ofrojnë ndihmë afatgjatë, këshillim dhe advokim për viktimat që i kanë mbijetuar dhunës seksuale ose ngacmimit seksual kohët e fundit ose në të shkuarën.

Konteksti i veçantë i rajonit duhet të merret gjithashtu në konsideratë gjatë vlerësimit të nevojës së mundshme për këto shërbime mbështetjeje. Siç vihet re në gjetjet e studimit të OSBE-së, një numër i konsiderueshëm grash janë ndikuar nga konfliktet e armatosura në rajon.

8 Termi "prevalencë" përdoret për të "shpjeguar sa, ose çfarë raporti (përqindje), e popullsisë ndikohet nga një fenomen i caktuar gjatë një periudhe të caktuar kohe (zakonisht, prevalenza gjatë gjithë jetës, ose prevalencia 12 mujore). Për shembull, prevalenza prej 10% e dhunës në 12 muajt e fundit do të thotë se, mesatarish një në 10 gra janë viktimiuzar një ose më shumë herë gjatë 12 muajve të fundit. Duke qenë se prevalencia numeron një viktimë vetëm një herë, pavarësisht faktit se ato mund të kenë përfjetuar një ose më shumë incidente, prevalencia e dhunës nuk pasqyron intensitetin e dhunës ose viktimiuzimin e përsëritur; ajo thjesht mat numrin, ose reportin e popullsisë që ka përfjetuar dhunë. Kur kampioni i anketimit është përfaqësues për popullsisë kombëtare (ose më gjérë), prevalencia e matur në kampion mund të konsiderohet si prevalencë përfaqësuese e popullsisë sipas marzheve të besueshmërisë, të cilët ndryshojnë nga njëri anketim në tjetrin" (Shihni më shumë në: Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore - FRA, 2014).

*“Ndjenyat post traumatike të përdhunimit të luftës janë të ngjashme me ndjenja pas torturës,..., çka e bën këtë krim dhe pasojat e tij si asnjë tjetër”*⁹ - Lepa Mladjenovic¹⁰
Në periudhën pas luftërave në Ballkanin Perëndimor, disa OFJ grash përfshiruan ekspertizë të konsiderueshme lidhur me mbështetjen e viktimate të përdhunuara në situatë lufte. Mbështetja e specializuar për këto viktima është ngritur në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Serbi, dhe përfaqësues të lëvizjeve

ndërkombëtarë të grave janë përfshirë në ofrimin e mbështetjes, trajnimit dhe ndihmës për OFJ-të e grave në rajon, me qëllim forcimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre për të ndihmuar viktimat e përdhunimit në situatë lufte. Kjo solli themelimin e një sërë organizatave të specializuara si Medica Zenica (BiH) dhe Vive zene nga Tuzla (BiH), të cilat ndër të tjera ofronin këshillim psikologjik afatgjatë dhe këshillim juridik. Këto organizata fituan përvojë në ofrimin e mbështetjes për viktimat e përdhunimit dhe torturës dhe kanë hartuar materiale dhe manualë që OFJ-të e grave i përdorin gjëresisht në punën e tyre. Për shkak të ndryshimit të përparësive në rajon, si p.sh. investimi i fondeve të pamjaftueshme nga shtetet në shërbime të specializuara mbështetjeje për cilëndo formë të DHKG11, një pjesë e këtyre dijeve dhe ekspertize të vyer të krijuar në kohë lufte, ka ‘humbur’ ose është negliguar dhe lënë mënjanë.

Kështu që, përdorimi i përvojës dhe ekspertizës së krijuar në të shkuarën lidhur me dhunën seksuale, do të ishte me përfitim për rimëkëmbjen e dijeve ‘të humbura’ dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Kjo mund të arrihet përmes trajnimeve të specializuara për dhunën seksuale, veprimtarive dhe rrjetëzimit përgritjen e kapaciteteve, duke qenë se OFJ-të e grave në këto vende në përgjithësi nuk kanë njojuri të specializuara për traumën seksuale, duke pasur kështu nevojë për trajnime të specializuara për të ndihmuar të mbijetuarat e abuzimit seksual të përballojnë dhe tejkalojnë traumën e tyre.

#Metoo në Ballkanin Perëndimor: nismat e kohëve të fundit për ndarjen e përvojave të dhunës seksuale

Lëvizja #MeToo nisi në Shtetet e Bashkuara në vitin 2017, pas skandalit që përfshiu producentin Harvey Weinstein. Producenti kinematografik amerikan u shpall fajtor

për ngacmim seksual, sulm seksual dhe përdhunim ndaj dhjetëra grave. Lëvizja shoqërore synoi t'i jepte fund heshtjes mbi abuzimin dhe ngacmimin seksual duke fuqizuar gratë të ndanin historitë e tyre në media sociale duke përdorur identifikuesin #MeToo.

Që prej hapave të parë në industrinë kinematografike të SHBA-së, lëvizja është përhapur shpejt në të gjitha vendet dhe fushat, me gjithmonë e më shumë gra që bëjnë publike traumën dhe përvojat e tyre.

Gjatë kohëve të fundit, gratë në vendet e ish Jugosllavisë (Kroaci, Bosnie dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Serbi) kanë bërë përpjekje për të hedhur drithë mbi abuzimin seksual dhe për të ndarë përvojat e abuzimit, duke organizuar një sërë nismash/grupesh në media sociale, dhe përkatësisht në Facebook. Këto përvuja shpesh përfshijnë raste të dhunës seksuale të kryer vite më parë, që nuk është denoncuar në polici apo në institucione të tjera.

Për shembull, pasi aktorja Milena Radulovic nga Serbia akuzoi pedagogun e dramës dhe regjisoren Miroslav Mika Aleksi për përdhunim dhe abuzim seksual, gra nga i gjithë rajoni u lidhën me njëratjetëren brenda vetëm pak orësh, duke ndarë traumat e tyre dhe duke shkëmbyer mesazhe: Nuk je vetëm (#NisiShama). Grupe të tillë si: ‘I didn’t ask for it (41.600 ndjekës); ‘I believe you (1.088 ndjekës)’; ‘No means no (3.277 ndjekës)’ u krijuan pikërisht me qëllimin për të inkurajuar gratë të besojnë tek vetvetja, duke i kërkuar shoqërisë të besojë rrëfimet e grave që kanë përjetuar abuzim seksual dhe duke mbështetur nisma të tillë si integrimi në kurrikulën e rregullt shkollore të metodave përikasjen e dhunës seksuale në Serbi.

Këto nisma nga baza dhe vullneti më i madh i grave në Ballkanin Perëndimor për të folur, përcaktojnë një nevojë të mundshme për shërbime të specializuara mbështetjeje, të organzuara veçanërisht për përbushjen e nevojave të viktimate të abuzimit seksual, sipas kërkësave të Nenit 15 të Konventës së Stambollit. Qeveritë në rajon, si dhe aktorët ndërkombëtarë duhet të dëgjojnë zërin e grave dhe vajzave.



9 Lepa Mladjenovic, Healing is justice [Shërbimi është drejtësi], <https://www.womenngo.org.rs/en/news/480-healing-is-justice>

10 Lepa Mladjenovic (feministe dhe bashkëthemeluese e WAVE) është një prej aktivisteve të rajonit që ka punuar për vite me radhë për të ofruar mbështetje/këshillim të specializuar për viktimat e dhunës seksuale, përfshirë viktimat e përdhunimit në situatë lufte.

11 Shihni për shembull reportin e GREVIO-s për Malin e Zi, 2018: reportin e GREVIO-s për Serbinë.

REKOMANDIME

1. Nevoja e mundshme për ngritjen e shërbimeve të specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës seksuale mund të përcaktohet nga të dhënat e prevalencës të theksuara më lart. Këto shërbime duhet të jenë të specializuara dhe të përshtatura për të përmbushur nevojat të të mbijetuarave të abuzimit seksual.
2. Në përputhje me Nenin 25 të Konventës së Stambollit, shtetet inkurajohen të ngrenë qendra të krizës së përdhunimit ose qendra të referimit të dhunës seksuale. Të dhënat e prevalencës dhe gjetjet për pasojat psikologjike tregojnë se në rajon mund të ketë më shumë nevojë për qendra të krizës së përdhunimit, duke qenë se atë ofrojnë ndihmë afatgjatë, këshillim dhe advokim për të mbijetuarat e dhunës seksuale.
3. Shumë OJF të g rave në rajon kanë përvojë të gjatë në ofrimin e shërbimeve të specializuara (kryesisht për viktimat e dhunës në familje), bazuar në parime feministe, përfshirë ndër të tjera një botëkuptim gjinor të DHKG, fuqizimit, respektimit të fshehtësisë. Disa prej tyre kanë 20 vjet përvojë në ofrimin e shërbimeve të specializuara. Për këtë arsy, agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe autoritetet shtetërore në rajon mund të marrin në konsideratë mundësinë e vënies në veprim të ekspertizës ekzistuese, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të tyre, duke mbështetur dhe/ose financuar trajnimet e specializuara për dhunën seksuale për anëtarët e OJF-ve të grave. Ekspertiza e OJF-ve të grave që trajtojnë në mënyrë specifike këtë çështje mund të merren në konsideratë dhe të përfshihen në krijimin dhe lehtësimin e këtyre trajnimeve.
4. Ofrimi i shërbimeve të përshtatshme të mbështetjes dhe fuqizimi i zërit të grave gjatë këtij procesi, janë të lidhura ngsushtë me punën parandaluese. Parandalimi luan rol kritik në ndryshimin e qëndrimit të publikut të gjerë, përfshirë palët e ndryshme të interesit dhe politikëbërësit, në tejkalimin e stereotipave gjinorë dhe në ndërgjegjësimin për çështje të veçanta. Shumica e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale kanë vendosur të mos i denoncojnë incidentet më të rënda të dhunës në polici apo në institucione a organizatat të tjera.¹³ Fuqizimi i grave për të kërkuar ndihmë dhe/ose mbrojtje në këto rrethana është një pjesë integrale e rolit që OJF-të e grave dhe palët e tjera shtetërore të interesit kanë tek mbështesin viktimat e dhunës seksuale.

III. Krijimi i një gjuhe të përbashkët: Shërbimet e mbështetjes së specializuar për viktimat e dhunës seksuale

Neni 25 i Konventës së Stambollit përmend dy lloje shërbimesh të specializuara që palët e traktatit duhet të ngrenë me qëllim ofrimin e mbështetjes më të mirë për viktimat e dhunës seksuale: *qendra të krizës së përdhunimit (QKP) dhe qendra të referimit të dhunës seksuale (QRDHS)*. Duhet theksuar se sipas Raportit Shpjegues të konventës, Shtetet palë nuk janë të detyruara të ngrenë të dyja llojet e qendrave, përkatësisht ato të krizës së përdhunimit dhe referimit të dhunës seksuale.¹⁴ Rekomandohet që një qendër e tillë të jetë e disponueshme për çdo 200.000 banorë dhe që shpërndarja e tyre gjeografike të lejojë aksesin e tyre nga viktima në zonat rurale, po ashtu si edhe në qytete.

Qendrat e Referimit të Dhunës Seksuale (QRDHS)

QRDHS-të ofrojnë kryesisht **kujdes imediat** për viktimat e dhunës seksuale. Shërbimet përfshijnë kujdes mjekësor/shëndetësor, mjeko-ligjor dhe psikologjik, si dhe sigurojnë ruajtjen e provave mjekoligjore. Shumica e shërbimeve dhe profesionistëve të QRDHS-ve janë pjesë e shërbimeve shëndetësore aktuale me financim publik. QRDHS-të përdoren nga të mbijetuarat gjatë javës menjëherë pas një sulmi, periudhë gjatë se cilës ka ende mundësi për të mbledhur prova mjeko-ligjore. Ato do të kenë mundësi të kenë akses edhe në kujdes mjekësor imediat. QRDHS-të do të ofrojnë edhe kujdes mjekësor ndjekës. Gjithmonë e më shumë QRDHS-të po ofrojnë mbështetje psikologjike afatmesme.

Praktika premtuese përfshin:

- **Trajinimet profesionale:** Stafi mjekësor dhe infermieror duhet të trajnohen në mënyrë të veçantë për kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore të dhunës seksuale dhe dhënien e kujdesit shëndetësor, dhe ky trajnim duhet të përfshijë traumën, elementet mjeko-ligjore dhe çështjet juridike;
- **Përputhshmëria me rregulloret:** Standardet profesionale dhe rregulloret, si ato mjekësore, infermierore, etj., duhet të zbatohen me përpikëri;

- **Bashkërendimi i shërbimeve:** Personeli shëndetësor, juridik dhe i advokimit duhet të drejtoshet nga një botëkuptim i përbashkët i roleve dhe detyrave të tyre të veçanta, si dhe nga respekti i ndërsjellë profesional. Idealisht, për një QRDHS duhet të hartohen standarde dhe protokolle ndërinstitucionale.¹⁵

Ndërkohë që QRDHS-të duhet të kenë parasysh traumën dhe të janë specialistë në kujdesin e ofruar pas dhunës seksuale, atyre nuk u nevojitet domosdoshmërisht një analizë feministe për të ofruar shërbime me në qendër të mbijetuarën. Shpesh kujdesi psikologjik përqendrohet në simptomat shkatërrimtare të traumës, sipas nevojave të të mbijetuarave menjëherë pas sulmit. Ato nuk luajnë domosdoshmërisht rol në të kuptuarin dhe sfiduarin e shkaqeve të dhunës seksuale.

Qendrat e Krizës së Përdhunimit (QKP)

QKP-të ofrojnë një mjeshtësi të sigurt për të mbijetuarat e dhunës seksuale kurdo dhe sidom që të mbijetuarat zgjedhin t'i qasen atyre. Të mbijetuarat mund të shkojnë në një QKP menjëherë pas incidentit, ose pas një periudhe të gjatë kohe. Këto shërbime mund të përfshihen përmes vetëreferimit, ose përmes referimit nga të tjerë, si për shembull mjeku i tyre.

Shërbimet e QKP-ve synojnë të ofrojnë mbështetje për të gjitha aspektet e dhunës seksuale gjatë të gjitha fazave të jetës. QKP-të punojnë për të kuptuar traumën, ndikimet dhe shkaqet e dhunës seksuale për të ndihmuar çdo të mbijetuar, në momentin që ato vendosin të marrin shërbim, të zgjedhin se si dëshirojnë të trajtojnë traumën dhe çfarë mbështetje ju nevojitet. Pra, shërbimet e QKP-ve janë të **'drejtuara nga të mbijetuarat'** dhe mbështeten tek angazhimi për të dëgjuar, t'u përshtatur, dhe bërë inovacion.

Një QKP zakonisht kombinon shërbime që përfshijnë linjat e ndihmës, këshillimin, psikoterapinë, advokimin dhe shoqërimin në procese juridike e deri mjekësore, për të mbijetuarat. Në partneritet me OJF të tjera mund të krijohen grupe më të vogla të personalizuara me qëllim përbushjen e nevojave të ndryshme të të mbijetuarave.

13 Raporti shpjegues i Konventës së Stambollit, pika 139.

14 Në vitin 2018, Irlanda hartozi kombëtare përfshirë mbështetur punën e QRDHS-ve. Këto udhëzime kombëtare të përbashkëta përfshirë QRDHS-të përcaktojnë se konsiderata parësore janë nevojat e një viktimit përfshirë kujdes shëndetësor. Këto udhëzime janë të disponueshme në linkun më poshtë: <https://www.hse.ie/eng/services/publications/healthprotection/sexual-assault-response-team-national-guidelines.pdf>

Shërbimet e krizës së përdhunimit i kushtojnë një pjesë të kapacitetit të tyre ndryshimit dhe parandalimit. Çdo e mbijetuar që përdor QKP-të e di se kur ato ndajnë rrugëtimin e tyre me një QKP, ato bëhen pjesë e një lëvizjeje për ndryshim. Një QKP angazhohet të transformojë komunitetin e vet bazuar në çka të mbijetuarat i mësojnë qendrës, duke ndërgjegjësuar, duke u angazhuar në arsim, dhe duke punuar me agjenci dhe profesione të tjera (si, policia, mjekët, etj.) për të përmirësuar përgjigjen e tyre ndaj të mbijetuarave dhe për të parandaluar dhunime të tjera.

Praktika premtuese në QKP përfshin:**16**

■ **Trajnimi profesional:**

- I gjithë stafi dhe vullnetarët kanë një botëkuptim të mirë të dhunës seksuale dhe traumës së dhunës seksuale. Stafi është i specializuar në rolet e tyre mbështetëse lidhur me dhunën seksuale;
- Programet e trajnimit duhet të janë të disponueshme për stafin dhe vullnetarët e qendrave;

■ **Mbrojtje për të gjithë stafin dhe vullnetarët:**

Mbikëqyrja zyrtare dhe kultura profesionale mbështetëse në qendrat e krizës së përdhunimit synojnë të mbrojnë stafin dhe vullnetarët nga përjetimi i traumës së të tjerëve;

■ **Fuqizimi i të mbijetuarave:**

- QKP-të nuk ushtrojnë kurrë trysni mbi të mbijetuarat për të marrë një shërbim apo për të denoncuar në polici, por u ofrojnë atyre informacion, zgjedhje dhe mbështetje pa paragjykim;
- Dinjiteti dhe fshehtësia e të mbijetuarave respektohen përgjatë gjithë procesit;
- Të gjitha detyrimet lidhur me raportimin shpjegohen plotësisht, për t'i lejuar të mbijetuarave të marrin vendime të informuara;

■ **Shërbimet e përshtatura:** Qendrat ofrojnë një shumëlojshmëri shërbimesh që mund të përshtaten për nevojat e të mbijetuarave: shoqërim këshillues, informacion ligjor, terapi në grup, vullnetarizëm, etj.;

■ **Bashkërendimi i qendrave:**

- Qendrat krijojnë rrjete me organizatat dhe shërbimet vendore për të siguruar përgjigjen më të mirë për çdo të mbijetuar;
- Qendrat rrjetëzojnë me qendrat homologe të krizës së përdhunimit për të ndarë mësimet e nxjerra, për të shumëfishuar zërin e tyre, hartuar dhe zhvilluar standarde dhe për t'i kërkuar njëra-tjetrës llogari. ■

REKOMANDIME

1. Qoftë përmes ngritisë së qendrave të krizës së përdhunimit apo qendrave të referimit të dhunës seksuale, këto shërbime duhet të janë të disponueshme për çdo 200.000 banorë dhe shpërndarja e tyre gjeografike duhet t'i bëjë të aksesueshme nga viktimat në zonat rurale dhe qytetet në mënyrë të barabartë. Për më tepër, këto shërbime duhet të janë të aksesueshme edhe nga grupet e grave të cenueshme.
2. Qendrat e referimit të dhunës seksuale duhet të ofrojnë kryesisht kujdes imediat dhe shërbimet duhet të përfshijnë kujdes mjekësor/shëndetësor, mjeko-ligjor dhe psikologjik, si dhe ruajtjen e provave mjeko-ligjore. Stafi mjekësor dhe infermieror duhet të trajnohen në mënyrë të veçantë për kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore të dhunës seksuale dhe dhënen e kujdesit shëndetësor; ky trajnim duhet të përfshijë traumën, elementet mjeko-ligjore dhe çështjet juridike.
3. Qendrat e krizës së përdhunimit duhet të ofrojnë një mjesid të sigurt për të mbijetuarat e dhunës seksuale kurdo dhe sidon që të mbijetuarat zgjedhin t'i qasen atyre. Ato ofrojnë mbështetje afatgjatë, duke punuar të kuptojnë traumën, ndikimin dhe shkaqet e dhunës seksuale, për të mbështetur të mbijetuarën në momentin që ato vendosin të përfshihen në shërbim. Qendrat e krizës së përdhunimit duhet të zbatojnë një qasje drejtimi nga të mbijetuarat dhe të mbështeten në angazhimin për të dëgjuar, t'u përshtatur, dhe bërë inovacion.
4. Është e rëndësishme të përshtaten modelet e zbatuara në Irlandë ose Mbretërinë e Bashkuan për kontekstin ligjor dhe praktik vendor të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Pavarësisht ngritisë se qendrave të krizës së dhunës dhe/ose referimit të dhunës seksuale, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis këtyre dy shërbimeve, dhe të punohet për çdo parim dhe koncept që vë të mbijetuarën në qendër të të gjithë ofrimit të shërbimeve.

13 Në Irlandë, QKP-të e ngritura përmes RRKPI kanë standarde praktike dhe qeverisje të përbashkët. Standardet më të përditësuara të shërbimit të krizës së përdhunimit janë hartuar nga Anglia dhe Uellsit në vitin 2018 dhe janë të disponueshme në: https://rapecrisis.org.uk/media/2162/rnss_partners_final.pdf

IV. Parimet, konceptet dhe arsyetimi në bazë të modelit të krizës së përdhunimit

Parimet dhe konceptet e mëposhtme skicojnë mundësinë e rikrijimit dhe zgjerimit që duhet të merret në konsideratë gjatë krijimit të shërbimeve afatshkurtra dhe/ose afatgjata të mbështetjes së specializuar për të mbijetuarat e dhunës në familje. Këto qasje janë zbatuar me sukses për dhjetëra vjet nga Rrjeti i Krizës së Përdhunimit në Irlandë. Shërbimet që synojnë të përshtatin dhe zbatojnë këto parime inkurajohen t'i ndryshojnë ato sipas nevojës së kontekstit kombëtar. Përmes zbatimit të këtij modeli për ofrimin e shërbimeve mund të krijohet një marrëdhënie besimi me të mbijetuarën dhe të mëkohet fuqizimi i saj afatgjatë

Krijimi i besimit përmes modelit të fuqizimit me në qendër të mbijetuarën të Qendrave të Krizës së Dhunës

Dhuna seksuale është një shkelje themelore e besimit, dhe kjo shkelje nuk ka të bëjë vetëm me autorin individualisht, por shpesh dhe mbase gjithmonë përfshin familjen, miqtë, komunititetet dhe agentët e shtetit. Funksioni themelor i qendrave të krizës së dhunës është të fitojnë besimin e të mbijetuarave, me qëllim mbështetjen e fuqizimit të tyre dhe kthimin e besimit ndaj të tjerëve, përfshirë agjencitë shtetërore, kur kjo është e përshtatshme. Kjo është një prej arsyeve për vëmendjen që i kushtohet çështjeve të fuqisë gjatë gjithë punës së QKP-ve, përfshirë edhe në marrëdhëni e mbështetjes dhe këshillimit. Fuqizimi i të mbijetuarës përfshin si fuqizimin personal të të mbijetuarës në çdo kontakt që ato mund të kenë me QKP-në, ashtu edhe fuqizimin e saj në shoqërinë e gjerë.

Fshehtësia është kritike për punën e qendrave të krizës së dhunës për krijimin e besimit, për respektimin e autonomisë së të mbijetuarave dhe për bashkëpunimin në një përgjigje të drejtuar nga e mbijetuara.

Modeli i QKP-së nuk është asnjëherë drejtues, gjykues, dhe është gjithmonë i informuar nga trauma, i drejtuar nga e mbijetuara, sepse QKP-të besojnë se përgjigjet më të mira të mundshme janë të drejtuar nga vetë të mbijetuarat, të cilat e dinë më mirë se për çfarë kanë nevojë, dhe kur të marrin

kontrollin që iu është hequr gjatë përvojës së dhunës seksuale. Ky është pëershruar si modeli i të mbijetuarës/rimëkëmbjes.

Modeli i të Mbijetuarës/rimëkëmbjes:

trajtimi i sistemeve traumatike si përgjigje krijuese dhe përshtatje ndaj ngjarjeve të tmerrshme. Modeli hulumton se si e mbijetuara ka mbijetuar me krijimtari gjatë traumës, ose gjatë traumës së përsëritur, dhe se si kanë mbijetuar me krijimtari më pas, duke marrë në konsideratë situatën e tyre në jetë. Ai thekson burimet dhe pikat e fortë pozitive të të mbijetuarës.¹⁷

Parimet e punës së QKP-ve për krijimin e besimit me të mbijetuarat:

- Krijimi i një vendi të sigurt ku të mbijetuarat me kalimin e kohës mund të kuptojnë me qartësi se ato janë të afta të komunikojnë me gjuhë dhe mënyra që për to kanë kuptim dhe që përbushin nevojat e tyre;
- Ofrimi i instrumenteve për të menaxhuar dhe tejkaluar simptomat shkatërrimtare të traumës (pagjumi, kujtesën e aktit, ankth, etj.);
- Promovimi i mirëqenies dhe përqendrimi në rritje dhe jo tek simptomat dhe defektet;
- Rikthimi dhe rithekimi i autonomisë së individit;
- Pëlqimi dhe fshehtësia e të mbijetuarës duhet të janë në thelb të të gjitha mbështetjeve;
- Pranimi se pabarazia gjinore është përcaktuesi më i rëndësishëm i abuzimit. Dhuna seksuale ndodh në një kontekst shoqëror, në vend që të jetë një akt dëmtues tërësisht individual.

Zëri i të mbijetuarës

Shpesh dhuna seksuale është e fshehur dhe të mbijetuarat heshtin. Natyra e fshehtë e dhunës seksuale e bën të vështirë trajtimin e saj publik. Megjithatë, asnjë e mbijetuar nuk ka përgjegjësinë të punojë për sjelljen

14 Herman, Judith Lewis. 1997. *Trauma and recovery. [Trauma dhe rimëkëmbja]* Nju Jork: BasicBooks konsiderohet ende si teksti themelor mbi traumën e dhunës në familje dhe asaj seksuale.

e ndryshimit. Rrëfimi i ndodhive të tyre mund të jetë i rëndë dhe me kosto. Kështu, QKP-të rreken të gjunjë mënyra fuqizuese për të dëgjuar dhe mbështetur zërat e viktimate në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme.

Hapi i parë në zbatimin e një qasje me në qendër viktimen kur mbështeten të mbijetuarat, është të kuptosh përsë ato heshtin. QKP-të nuk ushtrojnë asnjëherë trysni dhe nuk i shtrengojnë të mbijetuarat rrejejnjë ngjarjen e tyre, duke qenë abuziv në kërkësën për ngjarjet e tyre vlerësuar arsyet për heshtjen e tyre.

Disa arsyet përsë të mbijetuarat zgjedhin të heshtin:

- **Trysni nga autorit:** Autorët mund të janë anëtarë të pushtetshëm të familjeve, komuniteteve, vendeve të punës, etj.;
- **Trysnia nga humbja e gjithçkaje:** Të mbijetuarat mund të janë të interesuara të ruajnë strukturat e mbështetjes (si familja) nga shkatërrimi i sjellë nga e vërteta mbi dëmin që iu është shkaktuar;
- **Trysnia për ruajtur të afërmit nga dhuna:** Të mbijetuarat kuptojnë se familjet, komunitetet, organizatat mund të janë të interesuara të mbrojnë veten e tyre nga pranimi i dëmit që është shkaktuar brenda njësisë së tyre;
- **Trysnia shoqërore:**
 - Të mbijetuarat përballen me reagim të ashpër dhe rezikojnë dëmtim kur ngrenë zërin, sepse kanë 'shkaktuar' përcarje (të izoluar nga grupi, duhet të shpërgulen nga banesa, humbin vendin e punës, sulm fizik, etj.);
 - Të mbijetuarat mund të fajesohten dhe stigmatizohen nga profesionistët që duhet t'i mbrojnë dhe mbështesin ose nga familjet dhe/ose miqtë e tyre;
- **Dhuna administrative:** Të mbijetuarat mund të kenë qenë dëshmitare të kësaj vetëmbrojtjeje të institucionit shumë herë të tjera përparrë se atë vetë të viktimizoheshin.

Ngjarjet e të mbijetuarave krijojnë trysninë e miteve të ndryshimit: Këto mite krijojnë trysni mbi të mbijetuarat për të ngritur zërin dhe shpesh caktojnë prishmëri të paarritshme. Në ndryshim nga mitet, rrallë ndodh që ngjarjet e të mbijetuarave të sjellin ndryshime madhore.

Qendrat e krisës së përdhunimit kuptojnë se:

- Trysnia e medias dhe interesit në lajmet e përqendruara në 'interesin njerëzor' drejtojnë kërkësën për dëshmi nga të mbijetuarat për qëllimet e shitjes së medias (pavarësisht qëllimeve të mira të personave të përfshirë);
- Ngjarja e çdo të mbijetuarave është unike dhe nuk mund të përfaqësojë përvojat e të mbijetuarave të tjera;
- Të mbijetuarave mund t'u kërkohet të jalin informacion lidhur me motivimin dhe gjendjen mendore të autorit, çka nënkupton se e mbijetuarat kishte një farë kontrolli mbi autorin dhe se si pasojë ka përgjegjësi dhe faj. Por vetëm rrëfimet e autorëve mund të janë dëshmi e besueshme e gjendjes mendore të autorit.;
- Një përgjigje emocionale dhe empatike ndaj ngjarjes së një të mbijetuarave nuk është veprim dhe mund të mos sjellë ndryshim; Emocionet janë masë e dobët ndërhyrjeje.

Ka një sërë mënyrash për të mbështetur zërin dhe fuqizimin e të mbijetuarave ndërkohë që maksimizohet ndikimi dhe siguria e të mbijetuarave. Këto përfshijnë:

- **Sigurimin e mbështetjes:**
 - Rrëfimi i të mbijetuarës të lidhet me një 'kërkësë', që është veprim apo ndryshimi që kërkohet pas angazhimit të audiencës; dhe që kjo kërkësë të jetë realiste dhe e arritshme? A mund të bashkërendohet kjo 'kërkësë' me dhe të mbështetet nga një fushatë e qëndrueshme për ndryshim?
 - Mbledhja e të dhënave të të mbijetuarave për të treguar një ngjarje kolektive;
 - Kryerja e anketimeve të prevalencës;
 - Krijimi i rrëfimeve të përbëra (lidhja e ngjarjeve të disa të mbijetuarave së bashku për të treguar diçka të vërtetë, por jo ngjarjen e një të mbijetuarë të vetme);

- **Sigurimin e mbrojtjes:**
 - Respektimi dhe Mbështetja e të mbijetuarave për të rrëfyer ngjarjet në mënyrë anonime;
 - Përdorimi i citimeve të të mbijetuarave në mënyrë anonime;
 - Sfidimi i normave patriarkale;
 - Sfidimi i fajësimit të viktimës;
 - Sfidimi i miteve rreth dhunës seksuale;

- **Sigurimin e një procesi të drejtë drejtësie:**
 - Sigurimi i një përgjigjeje publike të drejtësisë penale që ruan jetën private dhe anonimitetin e të mbijetuarës; Kjo do të thotë se gjyqet duhet të raportohen në media sipas ligjeve dhe rregullave që ruajnë anonimitetin e të mbijetuarave;
 - Një proces transparent drejtësie - ku institucionet e drejtësisë mbledhin dhe publikojnë të dhëna rregullisht, si dhe statistika për çështjet e denoncuara, llojet e shkeljeve, masën e evidentimit çdo tre muaj dhe çdo vit.

Parimet drejtuese për viktimat në sistemin e drejtësisë

Angazhimi i të mbijetuarave është kritik për veprimtarinë shtetërore në kuadër të përligjjes së të drejtave të të mbijetuarave. Fakti që vetëm një pakicë e tyre angazhohen, është sfidë për sistemin juridik. **Është e rëndësishme të mos vijojmë ta shohim këtë si problem me të mbijetuarat, por të pyesim se çfarë mund të ndryshojnë palët e interesit në sistem.**

Një sistem drejtësie e përqendruar tek viktimat nënkuption nevojë për burime shtesë, por këto justifikohen me faktin se provat më të mira mblidhen kur një e mbijetuar zgjedh në mënyrë aktive të angazhohet me sistemin e drejtësisë.

Viktimat punojnë me sistemin kur ato janë të informuara dhe të mbështetura. Për më tepër, një sistem drejtësie që është në vetvete shkak për padrejtësi, ka dështuar si sistem. **Për këtë arsy, shteti duhet të bëjë gjithçka mundet për të minimizuar çdo mundësi traumatizimi të ri¹⁸ gjatë procesit, duke përforuar në maksimum dinjitetin, autonominë dhe zgjedhjen e të mbijetuarave në sistemin e drejtësisë.**

RRKPI-ja në partneritet me “Safe Ireland” në kuadër të grupit të punës të OJF-ve të përfshira në zbatimin e nismës ‘rrugëtimi i të mbijetuarave’ të Departamentit të Drejtësisë së Irlandës, harto parime udhëzuese për angazhimin e viktimateve në sistemin e drejtësisë. Këto mund të përdoren si praktikë premtuese, duke marrë parasysh ama se ka gjasa që ato të përputhen vetëm pjesërisht me juridiksione të tjera kombëtare. Këto udhëzime përfshijnë për shembull, respektimin e dinjitetit të çdo dëshmitari të cuneshëm në çdo ndërveprim, autonominë e dëshmitarit, mbrojtjen fizike të bazuar ngushtë tek individi dhe dhënen e informacionit të saktë dhe të përshtatshëm për procesin e drejtësisë penale të lexueshëm dhe të disponueshëm për të gjithë dëshmitarët e cuneshëm. ■

REKOMANDIME

1. Fshehtësia qëndron në thelb të krijimit të besimit të të mbijetuarave. Sa më shumë të mbrohet një e mbijetuar, aq më shumë gjasa ka që ato të denoncojnë zyrtarisht dhe të qëndrojnë në procesin e drejtësisë. Për shtetet palë është me vlerë të mbështesin vendet ku ruhet fshehtësia e të mbijetuarave. Shtetet palë duhet të punojnë për të mbështetur dhe arritur maksimumin e niveleve të fshehtësisë që QKP-të mund t'i ofrojnë të mbijetuarave.
2. Dhuna seksuale duhet të shihet si abuzim i pushtetit, ku pabarazia gjinore është përcaktuesi më i rëndësishëm i këtij abuzimi. Dhuna seksuale ndodh në një kontekst shoqëror, në vend që të jetë një akt dëmtues tërësisht individual.
3. Është e rëndësishme që të mbijetuarat të fuqizohen me qëllim që zëri i tyre të dëgjohet në një kontekst të sigurt dhe të përshtatshëm. Elementet kyçe të ngritisës së shërbimeve të specializuara të mbështetjes janë vënia e nevojave të viktimateve në qendër të të gjitha masave të mbrojtjes dhe mbështetjes, si dhe krijimi i marrëdhënieve të besimit.

15 Njihet edhe si traumatizim i dytë, ose viktimizim i dytë.

V. Politikat Strategjike: hapat drejt llogaridhënieve së shtetit

Kreu II i Konventës së Stambollit (Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave) përcaktojnë kërkësen bazë për një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës kundër grave: nevojën për politika mbarështetërore efikase, gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara të mbështetura në strukturat e nevojshme institucionale, financiare dhe organizative.¹⁶ **Kështu, një nga detyrimet themelore të shteteve është hartimi i politikave të mirëpërcaktuara dhe mirësynuara me qëllim luftimin e të gjitha formave të dhunës të përfshira në objektin e Konventës.** Këto politika mund të vijnë në formatin e Planeve Kombëtare të Veprimit (PKV) apo dokumenteve të tjera të politikave gjithëpërfshirëse.

Politikat kombëtare, për shembull planet kombëtare të veprimit, duhet të trajtojnë dhunën kundër grave në mënyrë gjithëpërfshirëse, përfshirë dhunën seksuale, me qëllim mbështetjen më të mirë të viktimateve të dhunës seksuale dhe zbatimin e një qasje gjithëpërfshirëse kur bëhet fjalë për çështjen e dhunës seksuale. Raportet bazë të GREVIO-s për vlerësimin e zbatimit të Konventës paraqesin një prije interesante: faktikisht shumica e PKV-ve janë të përqendruara vetëm ose kryesisht tek dhuna në familje.

Deri më sot në vitin 2021, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë nuk kanë Plane Kombëtare Veprimi (PKV)/Strategji Kombëtare të veçanta që trajtojnë dhunën seksuale. Sipas raporteve të partnerëve kombëtarë (partnerët CSSP)²⁰ në këtë projekt, aktualisht dokumentet e politikave kombëtare në fuqi trajtojnë kryesisht ose vetëm dhunën në familje/nga partneri intim. Kështu që, mund të arrihet në përfundimin se politikat kombëtare kanë prirje të anashkalojnë dhunën seksuale.

Në BiH, strategjia/PKV-ja aktuale në fuqi në nivel shteti i referohet vetëm dhunës në familje, dhe nuk përfshin asnjë masë specifike për dhunën seksuale; e njëjtë gjë vlen për dokumentet e hartuara në nivelin e të dy entiteteve (Federata e BiH dhe Republika Serpska). Afati i veprimit të PKV-së në Kosovë përfundoi së fundmi: përqendrimi i tij ishte vetëm në dhunën në familje dhe nuk përfshinte masa specifike për trajtimin e dhunës seksuale (një PKV e re për dhunën në familje është në procesin e miratimit).

Megjithatë, një sërë masash të lidhura me dhunën seksuale janë të përfshira në PKV-të aktuale të Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë, si dhe projekt Strategjisë në Shqipëri që deri në qershor të vitiit 2021 nuk ishte miratuar ende.

Në Serbi, masat që lidhen me përmirësimin e shërbimeve për viktimat e llojeve të ndryshme të dhunës me bazë gjinore janë përfshirë në Strategjinë e re për Parandalimin dhe Luftën ndaj Dhunës me bazë Gjinore kundër Grave dhe Dhunës në Familje (2021-2025), pra në masën 2.4: "Përmirësimi i shërbimeve të specializuara për gratë viktima të dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe dhunës në familje përmes përcaktimit të standardeve dhe garantimit të disponueshmërisë së shërbimeve për gratë nga grupet e ceneseshme." Gjithashtu, theksohet se kjo masë e veçantë përfshin shërbimet për viktimat e dhunës seksuale, me qëllim "trajtimin e mangësive që përfaqësojnë pengesa për ofrimin e shërbimeve në përputhje me Konventën e Stambollit dhe rekondimimet e GREVIO-s. Qendrat e specializuara të referimit janë të nevojshme për mbështetjen cilësore dhe mbrojtjen e viktimateve të dhunës të ofruara në të njëtin vend 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, përfshirë ekzaminimet mjekësore dhe mjeko-ligjore, mbështetjen psikologjike dhe këshillimin juridik, që janë thelbësore për viktimin jo vetëm për marrjen e provave për procedimin gjyqësor, por edhe për të siguruar rimëkëmbjen psikologjike". Gjithashtu, strategjia përfshin nevojën për të siguruar "financim buxhetor të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së shërbimeve të specializuara, si dhe caktimin e financimit për OJF-të që ofrojnë shërbime të specializuara për gratë që kanë përjetuar dhunë".

Në rastin e Malit të Zi dhe Shqipërisë, prirja përfshirjen e masave që lidhen me dhunën seksuale në PKV-të mund të shihet si përgjigje ndaj rekondimeve të GREVIO-s; në raportet e veta për Shqipërinë dhe Malin e Zi GREVIO ka identifikuar mungesën e shërbimeve të specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës në familje dhe i bën thirrje këtyre vendeve të ngrenë një numër të përshtatshëm qendrash të krizës së përdhunimit dhe/ose qendrash të referimit të dhunës seksuale, sipas

16 Kjo kërkësë është e shpjeguar në një sërë raportesh të GREVIO-s; shihni vetëm për shembull reportin e GREVIO-s për Turqinë, 2018.

17 <https://cssplatform.org/partners>

Nenit 25 të Konventës (shihni, reportin e GREVIO-s për Shqipërinë, 2017; Raportin e GREVIO-së për Malin e Zi, 2018). Shqipëria ka ndërmarrë hapa për zbatimin e rekomandimit më të fundit të GREVIO-s, dhe qendra e parë për viktimat e dhunës seksuale u ngrit së fundmi, më konkretisht ‘Qendra e Menaxhimit të Rasteve të Krizave për Rastet e Dhunës Seksuale’, Qendra Lilium, në kryeqytetin e vendit, Tiranë. Sipas shpjegimeve të partnerit kombëtar, projekt strategjia e cila është aktualisht në hartim e sipër në Shqipëri, planifikon një masë për “ngritjen e katër qendrave të reja të krisës (dy përfshirë dhe dy përfshirë) për të mbijetuarat e sulmeve seksuale.” Megjithatë, për momentin nuk është e qartë se çfarë lloj shërbimesh (afatgjata apo afatshkurtra) do të ofrohen nga këto qendra.

Në rastin e Malit të Zi, është për t'u vlerësuar fakti që ky vend ka miratuar një PKV që ka një sërë masash specifike që synojnë të mbështesin dhe mbrojnë viktimat e dhunës seksuale, përfshirë një masë për ngritjen e qendrës së parë për këto viktima. Megjithatë, duhet theksuar se bazuar në tekstin e PKV-së, nuk është e qartë nëse Mali i Zi ka zgjedhur të ngrejë një qendër krize të përdhunimit apo një qendër për referimin e dhunës seksuale (sipas termave të Konventës së Stambollit). Në PKV përdoret termi “Qendra për Viktimat e Dhunës Seksuale” pa përcaktim të mëtejshëm të shërbimeve që do të ofrohen në

këtë qendër, kështu që nuk mund të arrihet në përfundimin nëse puna e saj përpushtet me përkufizimin e ‘qendrës së krisës së përdhunimit’ apo ‘qendrës së referimit të dhunës seksuale’ (sipas termave të Konventës). Po ashtu, edhe Maqedonia e Veriut ka miratuar një Plan Kombëtar Veprimi për zbatimin e Konventës së Stambollit (2018-2023), siç edhe përshkruhet në raportin për zbatimin e këtij Plani Kombëtar Veprimi (Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, 2020). Partneri kombëtar në këtë projekt raporton se kjo PKV ka një sërë masash që trajtojnë në mënyrë të veçantë legjislacionin për dhunën seksuale dhe mbështetjen për viktimat; megjithatë, shumica e ndryshimeve të planifikuara nuk janë miratuar ende. Ka edhe masa të tjera që lidhen me shërbimet e specializuara, si “Themelimi i qendrave të Krisës për Viktimat e Dhunës Seksuale (72 orëshe), dhe Qendrës për Dhunën Seksuale dhe Përdhunimin (strehë)”, si dhe “Përgatitja e standardeve për shërbimet e specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë qendrën e Krisës për Viktimat e Dhunës Seksuale (72 orëshe), dhe Qendrën për Viktimat e Dhunës Seksuale (Strehë)”. Maqedonia e Veriut ka tashmë tre qendra të cilat janë ngritur në ambiente spitalore. Edhe në këtë rast, bazuar në tekstin e PKV-së, nuk mund të përcaktohet se çfarë lloj shërbimesh janë ngritur (ose planifikohen të ngrihen) në vend. ■

REKOMANDIME

Plani kombëtar i veprimit ose politika të tjera strategjike duhet të trajtojnë dhunën kundër grave në mënyrë gjithëpërfshirëse. Për çështjen e dhunës seksuale duhet të hartohen politika të veçanta. Megjithatë, praktika premtuese në politikëbërje tregon se dokumentet e politikave strategjike duhet të shoqërohen me mekanizma për zbatimin efikas të politikave, përfshirë por pa u kufizuar në, treguesit e qartë për matjen e ecurisë drejt përmbushjes së objektivave të propozuar.

VI. Dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual në ligj

Dhuna seksuale: qëllimi i Nenit 36 të Konventës së Stambollit është kriminalizimi i të gjitha akteve me natyrë seksuale pa pëlqim, përfshirë përdhunimin. Elementi qendror i përkufizimit të dhunës seksuale në konventë është mungesa e pëlqimit të dhënë si pasojë e vullnetit të lirë të individit.

Bazuar në përgjigjet e marra nga partnerët në këtë projekt dhe analizat e raporteve të GREVIO-s (kur janë të disponueshme), në një sërë vendesh të Ballkanit Perëndimore dhe në Turqi, përkufizimet e veprave seksuale në legjislacionin penal nuk janë të harmonizuara me konventën, përkatësisht ato nuk bazohen tek mungesa e pëlqimit të dhënë lirisht, megjithëse është identifikuar progres i konsiderueshëm për ndryshimin e legjislacionit në Malin e Zi, Turqi dhe Kosovë.

Ngacmimi seksual: Neni 40 i Konventës përcakton parimin se ngacmimi seksual mund t'i nënshtrohet sanksioneve penale dhe të llojeve të tjera. Megjithëse përgjithësisht parapëlqehet që këto krite të përfshihen në të drejtën penale, hartuesit kanë pranuar se shumë sisteme ligjore kombëtare

e përfshijnë ngacmimin seksual në të drejtën civile ose të punës. Si pasojë, shtetet palë të konventës mund të zgjedhin të trajtojnë ngacmimin seksual në kuadër të të drejtës penale ose përmes sanksioneve administrative dhe të llojeve të tjera, duke garantuar që ligji trajton ngacmimin seksual.²¹

Disa vende në Ballkanin Perëndimore dhe Turqia kanë kriminalizuar ngacmimin seksual, ndërsa të tjera kanë zgjedhur ta trajtojnë atë përmes legjislacionit të punës/ligjeve për barazinë gjinore/ligjet për ndalimin e diskriminimit. Ngacmimi seksual përcaktohet si Vepër e veçantë penale²² në Shqipëri, një entitet të BiH (Republika Serpska), Serbi, Turqi dhe Kosovë, dhe nuk është i kriminalizuar në Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, një entitet të BiH (Federata e BiH), si dhe në Distriktin e Brcko të BiH. Megjithatë, ngacmimi seksual në këto vendet/entitet e fundit është trajtuar në të Drejtën e Punës, Ligjin për Barazinë Gjinore, etj. Kështu, ngacmimi seksual i nënshtrohet sanksioneve të tjera (jo penale), dhe/ose përgjegjësive për mbrojtje ligjore (mund të kërkohet edhe kompensim për dëmet e pësuara). ■

REKOMANDIME

Ndryshimet ligjore (me gjasa) do të japid kontribut për një ndjekje më efikase penale. Në praktikën gjyqësore, përkufizimet që bazohen tek forca priren të kërkojnë provën e rezistencës fizike nga ana e viktimës (pa rezistencë nuk ka përdhunim), duke çuar kështu në shanse të pakta për shpalljen fajtor të autorit. Si pasojë, rekandohet që legjislacioni kombëtar të përafrohet me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut²³ dhe standartet e Konventës së Stambollit.

18 Siç shpjegohej më tej në një sërë raportesh të GREVIO-s (shihni për shembull reportin e GREVIO-s për Turqinë, 2017; reportin e GREVIO-s për Spanjën, 2020), vepra e ngacmimit seksual e përkufizuar në Neni 40 të Konventës përfshin të gjitha sjelljet e padëshiruara të një natyre seksuale, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë dinjitetin e një individit.

19 Për më tepër, në këto vende vepra e ngacmimit seksual nuk ndiqet penalisht kryesisht, procedimi penal lidhur me ngacmimin seksual mund të ndërmerrret vetëm në formën e ndjekjes penale private, që do të thotë se ndërmerrret vetëm bazuar në ankesën e viktimës.

20 Shihni çështjen përcaktuese të GJEDNJ-së: M.C. K. Bullgarisë, 2003

VII. Vlerësimi i nevojave të të mbijetuarave: Rëndësia e të dhënave

Një prej aspekte më kritike të zbatimit të Konventës së Stambollit është aftësia e një shteti për të treguar se e kuption shkallën e problemit dhe nevojat e të mbijetuarave dhe se çfarë masash janë marrë (nëse ka të tillë) dhe nëse janë efikase për t'i parandaluar dhe mbrojtur gratë nga dhuna. Sipas nenit 11 të Konventës së Stambollit, shtetet janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave përkatëse të kategorizuara në intervale të rregullta për çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha format e dhunës që mbulohen nga objekti i Konventës.

Një sfidë kyçë është fakti se shpeshherë, të dhënat nuk mblidhen, analizohen ose publikohen. Kjo heshtje do të thotë se është vështirë t'i vesh një emër performancës së dobët, ndërsa performanca e mirë mund të kalojë pa u vënë re.

Për të krijuar tablonë e përgjithshme të rrugëtimit të një të mbijetuareje, duhen analizuar grupe të ndryshme të dhënash si: të dhëna për prevalencën e popullsisë (anketim i kryer përmes një kampioni kombëtar përfaqësues të popullsisë p.sh nga ky anketim mund të identifikohet natyra reale dhe shkalla e dhunës seksuale në të gjithë popullsinë); të dhëna administrative (p.sh të dhëna të mbledhura nga policia, qendrat për trajtimin e krizave nga përdhunimi, gjykatat); të dhënat e të mbijetuarave (zakonisht të mbledhura nga OJF-të për gratë që ofrojnë këto lloj shërbimesh të specializuara, për shkak të mbështetjes konfidenciale dhe joqeveritare që i ofrojnë të mbijetuarave).

Për të analizuar modelet e mbledhjes së të dhënave administrative në rajon dhe për të vlerësuar nëse këto modele mund të përdoren me qëllim analizimin dhe përmirësimin e politikave kombëtare, partnerët e këtij projekti u pyetën nëse kishte të dhëna administrative të disponueshme në vendin e tyre, përfshi numrin vjetor të çështjeve të përdhunimit/çështjeve të formave të tjera të dhunës seksuale të raportuara në polici, si dhe shifrat vjetore të padive, akuzave penale dhe dënimive për përdhunimet/format e tjera të dhunës seksuale për vitin 2018-2019.

Nga raportet kombëtare të ofruara nga partnerët e CSSP-së nuk mund të krijohet një tabelë përgjithshme

- disa prej të dhënave të lartpërmendura nuk ekzistojnë, dhe/ose nuk janë të disponueshme për publikun (sipas kërkësës së Nenit 11 të Konventës), ose janë mbledhur por nuk janë koleksionuar në nivel kombëtar. Për shembull, në Maqedoninë e Veriut, partneri kombëtar raportoi për projektin se të dhënat për dënimet mund të merren duke bërë një kërkësë me shkrim pranë gjykatave të vendit, në përpjthje me ligjin për informacionin me rëndësi publike.

Në disa vende, si Shqipëria, Instituti i Statistikave publikon çdo vit raportin "Burrat dhe Gratë në Shqipëri", ku përfshihet edhe një kapitull për të dhënat gjyqësore, veçanërisht për dhunën kundër grave, përfshi edhe veprat penale seksuale.²⁴

Prandaj, në vijim do të merret rasti i Serbisë si shembull ilustrues.

Rasti i Serbisë

Në Serbi, të dhënat për çështjet e dhunës seksuale që raportohen në polici nuk janë të disponueshme për publikun, ndaj nuk është e mundur që të gjykojmë nëse të gjitha denoncimet kanë përfunduar me ngritjen e akuzave penale. Nga ana tjetër, Zyra Kombëtare Statistikore ofron të dhëna në nivel kombëtar për akuzat penale, paditë dhe dënimet për të gjitha veprat penale (siç parashikohen në Kodin Penal Serb). Këto të dhëna janë të disponueshme për publikun në faqen e internetit të Zyrës Statistikore të Republikës së Serbisë.

Studimet e mëparshme për zbatimin e standardit të kujdesit maksimal në Serbi (që përbën edhe një prej parimeve kryesore të Konventës së Stambollit) kanë analizuar tendencat lidhur me ndjekjen penale të të gjitha akteve kriminale të lidhura me DhKG-në, përfshi edhe dhunën seksuale rreth moshës 20-vjeçare.

(Brankovic, 2013;²⁵ 2015;²⁶ 2016²⁷), duke u mbështetur te të dhënat zyrtare për akuzat penale dhe dënimet. Për sa i përket veprës penale të përdhunimit, studimi tregoi se numri total i akuzave penale ka qenë shumë i ulët, nga 60 deri në 170 për periudhën 2002-2019. Madje, në vitin 2010, është shënuar ulje e mëtejshme, gjë që shihet si tendencë mjaft shqetësuese. Numri total i dënimeve për përdhunim ka qenë shumë i ulët. Duhet pasur parasysh se Serbia ka një popullsi prej afro

7²⁸ milionësh. Gjatë interpretimit të këtyre të dhënave, duhen marrë parasysh kufizimet metodologjike²⁹, si dhe fakti se procedimet penale për përdhunim zgjasin deri në katër vjet. Të dhënat tregojnë se ka mjaft vend për përmirësim në fushën e ndjekjes penale së përdhunimeve në Serbi. Për sa i përket veprave të tjera penale seksuale, vërehet një farë rritjeje e akuzave të ngritura. ■

REKOMANDIME

1. Rekomandohet që të përdoren kategori të harmonizuara të dhënash në sektorë të ndryshëm (p.sh polici, gjyqësor, kujdes shëndetësor), të kryhen analiza për normën dënimive, dhe të dhënat të kategorizohen sipas faktorëve të përmendur në dënim, të tilla si seksi dhe mosha e viktimës dhe autorit, apo edhe marrëdhënie midis tyre.
2. Ka shumë rëndësi që të dhënat administrative të mbidhen plotësisht dhe si duhet, në mënyrë që të jemi në gjendje të analizojmë përgjigjen institucionale/gjyqësore ndaj dhunës seksuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, dhe për të hedhur themelet e politikëbërjes në të ardhmen.

-
- 22 Brankovic, B. (2013). Të Reja nga e Ardhmja: Konventa e Stambollit dhe Përgjegjësia e Shtetit për të Luftuar Dhunën ndaj grave; Operacionizimi i Parimit të Kujdesit të Duhur. Beograd: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), (në serbisht) Versionin elektronik mund ta gjeni në: <http://www.sigurnakuka.net/sites/default/files/inline-files/VestilzBuducnosti.pdf>
- 23 Brankovic, B. (2015). Dhuna seksuale: Dalë nga harresa. Studim i paraqitur në Konferencën e Parë Ndërkombëtare për Dhunën Seksuale në Kroaci, organizuar nga Qendra e Grave për të Drejtat Seksuale, Komiteti i Barazisë për të Drejtat Seksuale, Komiteti për Barazi Gjinore i Qeverisë Kroate, Qendra për Edukim, Këshillim dhe Kërkim, dhe Komiteti për Barazi Gjinore i Parlamentit Kroat, Zagreb, Kroaci, Parlamenti Kroat, 23 tetor 2015.
- 24 Brankovic, B., në emër të GREVIO-s (2016). Barrierat e aksesit të grave në drejtësi - boshllëqet në plotësimin e kërkeseve të Konventës së Stambollit, *Studim i paraqitur në Konferencën Rajonale për Forcimin e Kapacitetit Gjyqësor për Përmirësimin e Aksesit të Grave në Drejtësi, organizuar nga Këshilli i Evropës në partneritet me Institutin Kombëtar të Drejtësisë së Republikës së Moldavisë, Chisinau, Moldavi, 24-25 tetor 2016.*
- 25 Përllogaritja e populsisë më 1 janar 2020: 6 926 705; Zyra Statistikore e Serbisë, <https://www.stat.gov.rs/en-us/oblasti/stanovnistvo/pro-cene-stanovnistva/>.
- 26 Modelet e mbledhjes së të dhënave nuk e përfshijnë llogaritjen e normës së dënimive (siç kërkohet nga Konventa, Neni 11); nuk është e mundur që çështjet të "gjurmohen" nga momenti i raportimit në polici deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, dhe për rrjedhojë të llogaritet përqindja e dënimive nga totali i numrit të çështjeve të reportuara. Duhet pasur gjithashtu parasysh se procedimet gjyqësore për përdhunimin zgjasin në kohë: studim i Akademisë Gjyqësore, realizuar në 2014-n (në Brankovic, 2015) tregoi se një procedim i vetëm për veprën penale të përdhunimit në Serbi zgjat deri në 4 vjet. Kjo është një prej arsyeve se përsë numri vjetor i dënimive për një vit të caktuar mund të jetë më i lartë se numri total i akuzave penale në atë vit. Prandaj, nuk mund ta analizojmë normën e dënimive (nga totali i numrit të akuzave penale në një vit të caktuar), por të dhënat për shifrat vjetore të akuzave penale dhe dënimive janë ende treguese të tendencave në këtë fushë.

VIII. Mbështetje për viktimat e dhunës në familje

Natyra traumatike e dhunës seksuale, që përfshin përdhunimin, kërkon një përgjigje veçanërisht të ndjeshme nga staf i trajnuar dhe specializuar, pasi viktimat e kësaj dhune kanë nevojë për kujdes dhe mbështetje të menjëherëshme mjekësore për traumën që kanë përjetuar, në kombinim me ekzaminimet e menjëherëshme mjeko-ligjore për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për ndjekje penale. Për më tepër, vërehet një nevojë mjaft e madhe për këshillim psikologjik dhe terapi, zakonisht shumë javë dhe muaj pas ndodhisë.³⁰

Bazuar në raportet kombëtare të partnerëve të CSSP-së, shërbimet e mbështetjes së specializuar janë ofruar për herë të parë në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Mbështetja e specializuar për viktimat e dhunës seksuale në Shqipëri është ofruar për herë të parë në kontekst spitalor, si program pilot.³¹ Qendra e parë e Menaxhimit të Krizave për Rastet e Dhunës Seksuale, Lilium, u hap në kryeqytet (Tiranë). Qendra është e disponueshme 24/7 dhe ofron shërbime sociale dhe shëndetësore për burra, gra dhe fëmijë, ofruar nga një ekip shumëdisplinor profesionistësh që përfshijnë gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, oficerë policie, avokatë dhe infermierë. Shërbimet afatshkurtra në qendër koordinohen me shërbime të tjera në komunitet, për të siguruar mbështeten afatgjatë të të mbijetuarave dhe qendra financohet nga shteti.³² Qëllimi i qendrës është të ofrojë shërbime të integruara, të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor, ekzaminim mjeko-ligjor, mbledhje provash për ndjekje penale dhe shërbime psikologjike. Për më tepër, qendra u ofron viktimate edhe ndihmë psikologjike dhe akomodim deri në 72 orë. Standardet minimale të cilësisë janë publikuar në Fletoren Zyrtare, të cilat duhen respektuar nga të gjitha agjencitë publike dhe private në të ardhmen.³³

Maqedonia e Veriut ngriti në vitin 2017 tre qendra në kontekst spitalor, që, sipas përshkrimit të punës së tyre,

duket se përshtaten me përkufizimin e “qendrave të referimit të dhunës seksuale” (referuar Konventës). Qendrat, si shpjegohet nga burimet WAVE dhe raportet e partnerëve kombëtarë, ofrojnë mbështetje urgjente mjekësore për gratë dhe vajzat që i kanë mbijetuar përdhunimit dhe ndodhen në klinikat gjinekologjike në tre qytete: Shkup, Kumanovë dhe Tetovë. Përveç ndihmës urgjente mjekësore të ofruar në këto qendra, koordinatori i Qendrave të Referimit të Përdhunimeve informon policinë dhe prokurorinë rrëth çdo rasti të dhunës seksuale, me pëlqimin e viktimës. Këto qendra menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë. Për më tepër, një prej strehëzave të viktimate të dhunës seksuale u themelua në vitin 2018, nën drejtimin e Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale.

Në **Mal të Zi**, linja e parë e këshillimit për të mbijetuarit e dhunës seksuale u krijua në vitin 2019 dhe drejtohet nga OJF-ja e malazeze e grave “Lobi i Grave”. Gjithashtu, Plani Kombëtar për Përmirësimin e Shërbimeve të Mbështetjes së Specializuar për Viktimat e Dhunës në Përputhje me Konventën e Stambollit 2019-2021 përfshin edhe një masë për ngritjen e një “Qendre për Viktimat e Dhunës Seksuale” në 2021-shin si dhe hartimin e udhëzimeve për punën e këtyre qendrave dhe stafin.

Në Serbi, siç theksohet edhe nga Raporti Bazë i GREVIO-s për Serbinë dhe Raporti i Hartëzimit WAVE34, janë ngritur tre Qendra për Viktimat e Dhunës Seksuale (QVDhS) në shtatë rajone të Provincës Autonome të Vojvodinës, si pjesë e projektit “Jepi fund-Kujdesu-Kuro!” drejtuar nga Sekretariati Provincor i Kujdesit Shëndetësor në partneritet me OJF-në e grave “Qendra për Mbështetjen e Grave” Kikinda. Këto shërbime ofrojnë kujdes mjekësor të menjëherëshëm, praktika mjeko-ligjore dhe ndërhyrje në raste krizash, dhe viktimat në këto qendra kanë akses në shërbime si këshillim ligjor, mbështetje psikologjike dhe psikoterapi. Në kohën e hartimit të këtij rapporti, në Vojvodinë ka pasur 4 QVDhS dhe teksa flasim vijojnë negociatat për hapjen e qendrave të reja.

27 Raport Shpjegues i Konventës së Stambollit, pika 138.

28 Nisma u mbështet nga UNDP-ja, shihni: <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/articles/2018/albania-sets-up- the-first-center-to-support-victims-of-sexual-violence.html>

29 WAVE (2019). Raporti WAVE për vandin 2019: Situata e shërbimeve të mbështetjes së grave në Evropë. Vienë: WAVE.

30 Informacion i marrë si pjesë e intervistës me përfaqësuesit e Qendrës Lilium, ofruar nga partneri kombëtar në këtë projekt.

31 https://cssplatform.org/wp-content/uploads/2019/10/CSSPWAVE_SVReport190927_web.pdf

Qendrat e Monitorimit të Fëmijëve (QMF) janë ngritur në 28 provinca të **Turqisë**. Që prej dhjetorit të 2020-s, janë hapur 53 qendra të tilla. Këto janë njësi të specializuara që operojnë në kontekste spitalore, duke synuar parandalimin e traumave dytësore te fëmijët viktima. Dekreti Presidencial

për Mbështetjen e Viktimate të Krimave Nr. 63, datë 10 qershor 202, përmban një dispozitë për qendrat e dhunës seksuale dhe përdhunimeve, ku përmendet se këto qendra ngrihen nga Ministria e Shëndetësisë, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë në shërbim të viktimate të dhunës seksuale. Këto qendra mund të ngrihen edhe nga universitetet.³⁵ Megjithatë, duke marrë parasysh Dekretin Presidencial të Turqisë të datës

20 mars 2021, për tërheqjen nga Konventa e Stambollit, ka shumë rëndësi të theksojmë se Turqia nuk është më e detyruar t'i bindet standardeve të mishëruara në Konventën e Stambollit.

Nga ana tjetër, në **Bosnjë-Hercegovinë**, format e mbështetjes së viktimate të dhunës seksuale janë krijuar shumë kohë më parë, në përgjigje të dhunës seksuale për shkak të konflikteve. OJF-të me përvjoë shumëvjeçare në ofrimin e ndihmës së specializuar për të mbijetuarit e abuzimit seksual ekzistojnë edhe në Serbi, 36 dhe disa organizata të tilla janë ngritur edhe në **Kosovë**.³⁷ ■

REKOMANDIME

1. Siç theksohet edhe në Raportin Shpjegues të Konventës së Stambollit, kryerja e ekzaminimeve mjekoligjore konsiderohet si praktikë e mirë, pavarësisht faktit nëse janë rapportuar në polici dhe viktimate duhet t'u ofrohet mundësia e marrjes dhe ruajtjes së mostrave, në mënyrë që vendimi për ta denoncuar përdhunimin të merret më vonë.
2. Rekomandohet që ofrimi i shërbimeve të mos varet nga vullneti i viktimate për të ngritur akuza ose dëshmuar kundër autorit.
3. Qendrat për viktimat e përdhunimit dhe dhunës seksuale duhet të ofrojnë shërbime mjekoligjore dhe mjekësore, si dhe mbështetje rezidenciale dhe jorezidenciale. Viktimat duhet të janë në gjendje të kërkojnë shërbime kurdo pas sulmit, përfshi edhe disa vite më vonë.

32 NENI 9- (1) Për sa i përket zbatimit të pikës pesë dhe gjashtë të Nenit 236 të Kodit të Procedurës Penale, për të parandaluar rivictimizimin e viktimate të dhunës seksuale, procedurat gjyqësore dhe mjekësore kryhen nga oficerë të trajnuar në këtë fushë. Qendrat janë ngritur nga Ministria e Shëndetësisë, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, në shërbim të viktimate. Qendra të tilla janë ngritur edhe nga universitetet.

33 Shihni: Qendra për Traumat nga Incestet, Beograd, <http://incesttraumacentar.org.rs/index.php/o-nama/>

34 Shihni: Medica Gjakova, <https://www.peaceinsight.org/en/organisations/mg/?location=western-balkans&theme>

IX.Protokollet ose udhëzimet që rregullojnë detyrat e profesionistëve dhe procedurave në rastet e dhunës seksuale, përfshi edhe përdhunimin

Për sa i përket protokolleve/udhëzimeve ekzistuese për profesionistët që merren me trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, bazuar në përgjigjet/raportet e partnerëve të CSSP-së dhe të GREVIO-s, mund të arrihet në përfundimin se protokollet/udhëzimet ekzistuese për profesionistët (policia, gjyqësori, profesionistët e kujdesit shëndetësor, punonjësit socialë, stafi mësimor etj.)

trajtojnë vetëm (ose kryesisht) dhunën në familje, ndërsa udhëzimet lidhur me ofrimin e mbështetjes për të mbijetuarat e dhunës seksuale ose mungojnë, ose nuk janë zhvilluar sa duhet.

Për shembull, në raportin e vlerësimit të GREVIO-s për **Serbinë** (2020),³⁸ GREVIO ka vlerësuar me nota pozitive hartimin e protokolleve që rregullojnë detyrat dhe përgjegjësitet e grupeve përkatëse të profesionistëve (si policia, punonjësit socialë, profesionistët e kujdesit shëndetësor etj.), por vëren se këto mbulojnë vetëm rastet e dhunës në familje. Institucioni mirëpërt Protokollin Special të Ministrisë së Shëndetësisë për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Viktimate Gra të Dhunës në Serbi, që është miratuar në vitin 2010, por vëren se dokumenti më i fundit vërtet mbulon dhunën fizike, psikologjike dhe seksuale që përfshin përdorimin e forcës, kanosjen ose kërcënimin fizik, por nuk marrin parasysh format e tjera të dhunës që mbulohen nga Konventa. Për më tepër, GREVIO vëren se në Serbi, ka marrë masa për zhvillimin e strukturave të institucionalizuara kryesisht për dhunën në familje, por jo për forma të tjera të dhunës.

Gjatë analizimit të problematikës lidhur me disponueshmërinë e protokolleve/udhëzimeve për profesionistët në Serbi, duhet shtuar se në kuadër të projektit të zbatuar në Provincën Autonome të Vojvodinës, është hartuar edhe një udhëzues³⁹ në 2019-n, i cili përshkruan procedurat për profesionistët mjekësorë dhe të tjerë, dhe shpjegon standardet mbi të cilat duhet bazuar ofrimi i shërbimit. Për më tepër, përgjatë vitit 2020, kapacitetet e QVDHs-së që ofrojnë mbështetje për viktimat ndaj dhunës

kundër grave dhe vajzave në kuadër të pandemisë, janë forcuar përmes tre protokolleve:

- 1) Protokolli i parë u hartua për të siguruar testim të detyrueshëm për sëmundjet infektive dhe seksualisht të transmetueshme për shkak të dëmtimeve të pësuara gjatë dhunës seksuale.
- 2) Protokolli i dytë synon të sigurojë përmirësimin e koordinimit midis grupeve të punës nëpër spitale. Dhe grupeve të koordinimit dhe bashkëpunimit brenda prokurorisë, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së viktimate të dhunës seksuale në përputhje me standartet më të larta të etikës dhe sigurisë.
- 3) Protokolli i tretë u hartua së bashku me qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ambulancat gjinekologjike me qëllim zgjerimin e objektit të institucioneve të kujdesit shëndetësor të përfshira në ofrimin e asistencës direkte në favor të grave viktima të dhunës seksuale, dhe rritjes së njojurive dhe ndërgjegjësimit të profesionistëve në kuadër të qendrave të kujdesit shëndetësor parësor dhe pacientëve rrith punës dhe shërbimeve të ofruara nga qendrat e trajtimit të krizave nga përdhunimi.

Në bashkëpunim me Fakultetin Mjekësor të Universitetit Novi Sad, Qendra për Mbështetjen e Grave hartoja programin arsimor për rolin e sektorit shëndetësor në mbrojtjen e grave viktima të dhunës, akredituar nga Këshilli Shëndetësor i Serbisë, dhe ka zhvilluar Platformën e të Nxënëtit Online me qëllim përmirësimin e njojurive dhe aftësive të profesionistëve të kujdesit shëndetësor për të ofruar në mënyrë aktive shërbimet e kujdesit shëndetësor për gratë viktima të dhunës seksuale, përmirësuar njojuritë dhe aftësitetë për bashkëpunimin dhe komunikimin midis ekipeve shumësektorale dhe njojuritë dhe aftësitetë për dokumentimin dhe regjistrimin e dhunës në familje, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën seksuale.

35 <https://rm.coe.int/grevio-report-on-serbia/16809987e3>

36 Todorov, D., Stevkovic, Lj., Veselinovic, I., Josimovic, S. (2019). *Udhëzime për sjelljen në rastet e dhunës seksuale brenda qendrave të referimit të dhunës seksuale në Provincën Autonome të Vojvodinës*. Novi Sad: Sekretariati Provincial i Kujdesit Shëndetësor të Provincës Autonome të Vojvodinës dhe Qendrës për Mbështetjen e Grave, Kikinda (në serbisht).

Në Bosnjë-Hercegovinë (më saktë në Republikën Sérpska) janë krijuar disa materiale burimore⁴⁰, të cilat përfshijnë udhëzime për profesionistët që ofrojnë mbrojtje dhe mbështetje për viktimat e formave të ndryshme të dhunës, përfshi edhe dhunën seksuale (për policinë, prokurorët, gjyqtarët, profesionistët shëndetësorë). Këto materiale burimore tregojnë se “viktimat e dhunës seksuale” duhen referuar/shoqëruar për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore dhe mjeko-ligjore pranë një institucioni të autorizuar shëndetësor, zakonisht gjinekologjik në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor pas raportimit të veprës penale në polici, dhe profesionistët shëndetësorë janë të detyruar të raportojnë të gjitha dyshimet rreth abuzimit seksual nëse gjatë ekzaminimit mjekësor të pacientit gjejnë shenja dhune. Nuk ka informacion nëse ekzaminimi mjeko-ligjor duhet paguar nga viktima. Paketa burimore për profesionistët shëndetësorë (referuar më lart) tregojnë se profesionisti ligjor që jep ndihmën mjekësore dhe kryen ekzaminimin këshillohet që të mos i ushtrojë presion viktimës për të konfirmuar dhunën. Këshillohet që viktima të japë pëlqimin e saj me shkrim për ekzaminimin që do të kryhet nga profesionisti shëndetësor dhe publikimin e të dhënave të mbledhura. Një prej formave të sugjeruara të mbledhjes së të dhënave gjendet brenda paketës burimore. Ekzaminimi mjeko-ligjor i nënshtrohet kontrollit të repte të prokurorit, i cili mund të pranojë gjetjet/opinionin e mjekut specialist. Megjithatë, nëse këto gjetje do të përdoren si provë në procedimin penal, prokurori eshtë i detyruar të urdhërojë ekzaminimin e tyre nga një dëshmitar ekspert, që do të thirret nga gjykata për të dhënë mendimin e tij/saj gjatë gjyqit. Ky rregull gjen zbatim përgjithësisht për veprat penale dhe jo vetëm për veprat penale të lidhura me dhunën seksuale.

Në Mal të Zi, eshtë hartuar një plan (siç përmendet në Planin Kombëtar të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve të Mbështetjes së Specializuar në përputhje me Konventën e Stambollit 2019-2021) për zhvillimin e një protokolli të veçantë në 2021-shin, i cili titullohet: Protokoli për trajtimin, parandalimin dhe mbrojtjen e viktimate të dhunës seksuale.

Megjithatë, reagimet e partnerëve kombëtarë tregojnë se dispozitat ligjore ose procedurat e parashkruara (p.sh.

aktet nënligjore) që rregullojnë punën e agjencive shtetërore nuk janë në të njëjtën linjë me Konventën e Stambollit, për të ofruar p.sh ekzaminime mjekësore dhe mjeko-ligjore për të gjitha viktimat, pavarësisht gatishmërisë së tyre për ta raportuar dhunën. Rregulloret në vendet përkatëse janë (kryesisht) kufizuese në këtë drejtim, pasi ekzaminimet mjeko-ligjore janë subjekt kërkese pranë agjencisë ligjzbatusë ose prokurorisë. Prandaj, ekzaminimi mjeko-ligjor varet nga raportimi i mëparshëm i viktimës pranë policisë ose prokurorisë. Për më tepër, në disa vende, vërehet edhe një problem tjeter: duke qenë se ofrimi i ekzaminimeve mjeko-ligjore cilësore eshtë i kufizuar, viktimate u duhet ndonjëherë të mbështeten te ekzaminues mjeko-ligjorë jospecialistë, ose të paguajnë tarifën për ekzaminim mjeko-ligjor nga një ekspert.

Për shembull, në Maqedoninë e Veriut, partneri kombëtar shprehet se “Viktima duhet t’ia raportojë rastin policisë për të marrë ekzaminim mjeko-ligjor zyrtar; ai/ajo nuk mund të kërkojë vetë ekzaminim mjeko-ligjor, për këtë ka një ekip të veçantë që raporton për gjendjen e tij/saj dhe dëmtimet nga dhuna seksuale”. Në mënyrë të ngjashme, në Malin e Zi, partnerët kombëtarë raportojnë se “Ekzaminimet e viktimate të dhunës seksuale kryhen në spitalet parësore dhe në Qendrën Klinike të Malit të Zi. Profesionistët dhe institucionet që njihen si subjekte mbrojtëse, të cilave viktimat mund t’u qasen dhe raportojnë krimin janë policia, prokuroria, gjyqtarët dhe profesionistët shëndetësorë. Pas raportimit të policisë, viktima i referohet/shoqërohet për të kryer ekzaminimet mjeko-ligjore dhe mjekësore pranë institucioneve shëndetësore të autorizuara, zakonisht, gjinekologjike të kujdesit shëndetësor parësor.

Në Turqi, siç qartësohet nga partneri kombëtar, procedura e zbatueshme pas përdhunimit përfshin: “Kur një grua raporton pranë organeve policore/ligjzbatusë se ka qenë viktimë e përdhunimit ose sulmeve të tjera seksuale, i merret dëshmia sipas udhëzimit të prokurorit dhe shoqërohet nga policia në spital për ekzaminimet. Ekzaminimet e gjenitaleve, pa vendim gjykatë apo prokurorie, janë veprat penale.

37 Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës Sérpska dhe UNFPA (2015). Paketë Burimore për Përgjigjen e Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Republikën Sérpska. Banja Luka: UNFPA, <https://www.vladars.net/sr-SP-Cyril/Vlada/Ministarstva/MZSZ/Documents/UNFPA%20Resursni%20Paket%20Light%20FINAL2.pdf> (në gjuhën boshnjake-kroate-serbe), dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Bosnjë-Hercegovinës (2018). Manuali i Veprimit për Rastet e Dhunës Gjinore dhe Seksuale kundër Grave dhe Fëmijëve për Policët, Prokurorët dhe Gjyqtarët, https://vstv.pravosudje.ba/vstv/faces/docservert?p_id_doc=48586

vepër penale në Turqi (Neni 287 i Kodit Penal Turk).⁴¹ Në një çështje penale, gruaja u mor nga spitali nga policia/xhandarmëria me udhëzim të prokurorit, dhe rasti u regjistrua si çështje gjyqësore/penale në spital. Gruaja ekzaminohet nga eksperti mjeko-ligjor (dhe/ose gjinekologu) që regjistron gjetjet dhe përgatit raportin. Pas sulmit seksual, nëse gruaja dërgohet direkt në spital, procedura është që mjeku duhet të njoftojë autoritetet,

duke filluar me policinë e spitalit. Nëse gruaja nuk dëshiron ta raportojë krimin, mund t'i kërkojë mjekut të mbledhë dhe regjistrojë provat. Megjithatë, për ekzaminimin e gjenitaleve nevojitet vendimi i gjyqtarit ose prokurorit. Nuk ka informacion përfaktin nëse ekzaminimi mjeko-ligjor duhet paguar nga gruaja apo jo" ■

REKOMANDIME

1. Duhen zhvilluar protokolle dhe udhëzime të përshtatshme përfaktore për profesionistët, pasi viktimat e dhunës seksuale përballen me paragjykimin e profesionistëve kur përpilen të aksesojnë sistemin e drejtësisë penale.
2. Procedurat dhe udhëzimet duhet të janë në linjë me praktikat që kërkojnë kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore nga praktikues të aftë, pa vonesa, pavarësisht nëse incidenti do t'i raportohet autoritetete apo jo. Viktimat duhet t'i nënshtronen ekzaminimeve mjeko-ligjore pa iu dashur ta raportojnë paraprakisht krimin në polici.
3. Mbledhja dhe ruajtja e provave duhet të jetë e mundur kurdo që viktima të marrë një vendim në një moment të dytë nëse dëshiron ta raportojë dhunën apo jo.

38 Neni 287 i Kodit Penal Turk (ekzaminimi i gjenitaleve) lexon si vijon:

(1) Kur një person kryen vetë ose përmes të tjerëve ekzaminimin të gjenitaleve pa vendimin e një gjyqtari ose prokurori të autorizuar, ai person dënohet me burg tre muaj deri në një vit.
(2) Dispozita më lart nuk gjen zbatim për ekzaminime të cilat janë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit ose dekretit që synojnë mbrojtjen e publikut nga sëmundjet infektive.

X. Raportimi nga profesionistët

Neni 28 i Konventës përcakton se palët marrin masat e nevojshme për të garantuar që rregullat e fshehtësisë të vendosura nga ligji i brendshëm mbi profesionistë të caktuar, sipas kushteve përkatëse, të mos pengojnë mundësinë e njoftimit të tyre pranë organizatave ose autoritetet e kompetente, nëse kanë arsyë të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune i mbuluar nga objekti i kësaj Konverte dhe priten akte të mëtejshme të rënda dhune.

Raportimi nga profesionistët, interpretimi i GREVIO-s

“GREVIO gjykon se kërkesa që rrjedh nga neni 28 i Konventës është formuluar me kujdes, në mënyrë që kur ka arsyë të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune dhe parashikohen akte të tjera të tillë, profesionistët mund t'i raportojnë dyshimet e tyre pranë autoritetet e kompetente pa rezikuar ndëshkim për shkeljen e detyrës ose të fshehtësisë së tyre profesionale. Kjo dispozitë nuk vendlodhet detyrimin për raportim. Në fakt, raportimi i detyrueshëm mund të përbëjë barrierë për të kërkuar ndihmë për gratë viktima që nuk ndihen gati për të ndërmarrë procedura formale dhe/ose që i tremben pasojave të raportimit për ta, ose për fëmijët e tyre (për shembull, shpagimi nga abuzuesi, pasiguria financiare, izolimi social ose largimi i fëmijëve nga kujdesi i tyre.) Kur autoritetet kanë vendosur detyrime të detyrueshme për profesionistët, GREVIO gjykon se këto duhet të lejojnë balancimin

e nevojave për mbrojtje të viktimate, duke përfshirë ato të fëmijëve të tyre, lidhur me autonominë dhe fuqizimin e viktimate, dhe duhet të kufizohen në rastet kur ka arsyë të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhunë i mbuluar nga objekti i konventës dhe priten akte të mëtejshme të rënda”⁴²

Duke u mbështetur në përgjigjet/raportet e partnerëve kombëtarë në këtë projekt, si dhe në raportet e GREVIO-s në Shqipëri (2017), Mal të Zi (2018), Serbi (2020), dhe Turqi (2018), mund të arrihet në përfundimin se dispozitat ligjore dhe/ose rregulloret mbi raportimin e detyrueshëm nga profesionistët në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi nuk bazohen në qasjen e balancuar të përmendur më sipër.

Nuk ka masa mbrojtjeje që do të siguronin balancën e duhur ndërmjet mbrojtjes së viktimate nga njëra anë dhe respektimit të autonomisë së tyre nga ana tjetër. Për më tepër, ligjet dhe/ose rregulloret e disponueshme përcaktojnë se ata profesionistë, kryesish profesionistë e mjekësisë, kanë detyrimin ligjor strikt për të raportuar dhunën, sa po ta kenë identifikuar gjatë punës së tyre të përditshme.

Mosraportimi trajtohet si veprë penale ose veprë e lehtë.

Detyrimet strikte të raportimit nga profesionistët mund të kenë ndërlidhime të rënda në rastet e dhunës seksuale dhe mund të ndikojnë në sjelljen e viktimate për të kërkuar ndihmë. Detyrimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor për të raportuar mund të krijojë bariera për të kërkuar ndihmë mjekësore, pasi viktimat mund t'i tremben raportimit të detyrueshëm dhe ndërmarrjes së procedimeve ligjore kundër vullnetit të tyre. ■

39 GREVIO (2020). Raporti i Vlerësimit (Bazë) të GREVIO-s mbi masat ligjore dhe masat e tjera që i japin efekt dispozitive të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit): Maltë. Strasburg: Sekretariati i mekanizmit të monitorimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje

REKOMANDIME

1. Në bazë të rekomandimeve të mëparshme të GREVIO-s (si reporti i vlerësimit i GREVIO-s për Maltën), detyra për të raportuar e caktuar për profesionistët duhet të balancohet nga informacion i plotë dhe i ndjeshëm që i ofrohet viktimës për ta lejuar që të marrë vetë një vendim të informuar dhe të ruajë autonominë.
2. Detyrimi i profesionistëve për të raportuar dhunën duhet të rishikohet kur bëhet fjalë për raportimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve të tyre, përvçse në situata kur ka arsyë të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune dhe priten akte të mëtejshme të rënda të tilla.
3. Duke qenë se viktimat e dhunës seksuale mund të kenë frikë që t'iu drejtohen shërbimeve të specializuara shtetërore, duke e ditur se stafi në këto shërbime ka detyrimin strikt për të raportuar dhunën në polici, viktimate duhet t'iu ofrohet mundësia për t'iu drejtuar OJF-ve të grave që do të ofronin mbështetje konfidenciale. OJF-të e grave ofrojnë avantazhin e nxitjes së grave që të flasin, sidomos të atyre grave që nuk dëshirojnë të depozitojnë një ankesë dhe që mund të mendojnë se duke iu drejtuar një shërbimi shtetëror ato do të detyrohen ta bëjnë diçka të tillë, ose do ta ekspozojnë në çdo rast autorin ndaj hetimit penal.
Prandaj, me qëllim krijimin e besimit nga ana e viktimës, pavarësisht nëse është ndërmarrë ndonjë hap ligjor apo administrativ, shërbimet e ofruara nga OJF-të nuk duhet të kenë detyrimet strikte të raportimit.⁴³

40 Shihni konsiderata të mëtejshme lidhur me nenin 25 mbi mbështetjen për viktimat e dhunës seksuale (Konventa e Stambollit).

XI. Rasti për autonominë e OJF-ve të grave⁴⁴

Nuk mund të ketë përgjigje të besueshme ndaj dhunës seksuale pa angazhimin dhe bashkëpunimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale. Sistemi formal i drejtësisë penale, me shifrat e tij të ulëta të raportimit dhe dënimit në nivel universal mbi dhunën seksuale, vuan për legitimitet në këto rrithana.

Shërbimet e dhunës seksuale dhe OJF-të e grave ekzistojnë për t'iu shërbyer të mbijetuarave. Detyra e parë e OSHC-ve të grave është të fitojnë besimin e të mbijetuarave. Kjo marrëdhënie besimi dhe angazhimi e të mbijetuarës, konkretisht sepse nuk janë organe shtetërore, është arsyaja se përsë shteti duhet të vlerësojë dhe të financojë punën e OJF-ve të grave. OJF-të si aktorë joshtetërorë luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e qeverive për të përmbushur detyrimet e tyre, duke ofruar mbështetjen dhe përgjigjet që të mbijetuarat kanë nevojë dhe gëzojnë të drejtë për t'i marrë, pa pasur nevojë që të eksposozhen ndaj shtetit. Një nga angazhimet bazë që OJF-të e grave bëjnë ndaj të mbijetuarave është se ato nuk do të vihen në presion apo nuk do të detyrohen të përfshihen me shtetin, dhe se shërbimet dhe mbështetja e OJF-ve janë konfidenciale.

Prandaj, mbrojtja e asetit unik të autonomisë dhe pavarësisë së OJF-ve të grave është një mënyrë që shteti të përmbushë nevojat e të mbijetuarave aty ku nuk e bën dot drejtpërdrejt. Financimi nga qeveria i shërbimeve mbështetëse të specializuara për gratë që ofrohen nga OJF-të është një mënyrë që shteti të përmbushë detyrimet e tij që rrjedhin nga Konventa e Stambollit, në mënyra që në të kundërt do të ishin të pamundura.

Rëndësia e financimit të qëndrueshëm afatgjatë për shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë

Nëse duhet të ngrihen shërbime të reja mbështetëse të specializuara për të përmbushur nevojat e të mbijetuarave të abuzimit seksual mund të shtrohet pyetja: si do të financohen këto shërbime?

Financimi i aktivitetave të ofrimit të shërbimit është zakonisht i bazuar në projekt dhe ka pak vullnet politik dhe/ose mbështetje administrative lokale për të siguruar qëndrueshmërinë e projekteve të zbatuara nga shërbimet e OJF-ve të grave. Sipas raporteve bazë të GREVIO-s, "OJF-të e grave në Serbi, Shqipëri dhe Mal të Zi janë të varura nga donatorë ndërkombëtarë, çka ngre çështjet e qëndrueshmërisë afatgjatë të shërbimeve të ofruara nga OJF-të. Shumë aktivitete të ndërmarra kanë natyrë projekti dhe rrjedhimisht kanë kohëzgjatje të kufizuar. Ekspertiza që zhvillohet në këto skema humb lehtë pa financimin e nevojshëm ndjekës dhe pa mbështetjen e nevojshme politike dhe administrative lokale për të pranuar sponsorizim të huaj dhe për të siguruar vazhdimësinë në nivel lokal." Ratifikimi i Konventës së Stambollit do thotë se palët angazhohen për të alokuar burimet e duhura financiare dhe njerëzore për aktivitete lidhur me luftimin e dhunës ndaj grave, të cilat kryhen si nga autoritetet publike ashtu edhe nga OJF-të përkatëse të grave. ■

REKOMANDIME

1. OJF-të e grave luajnë një rol të rëndësishëm për të siguruar se palët i përmbushin detyrimet e tyre që rrjedhin nga Konventa e Stambollit. Alokimi i financimit të qëndrueshëm për OJF-të e grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi mundëson në fund të fundit fuqizimin e të mbijetuarave dhe ofrimin e mbështetjes së duhur për gratë viktima të dhunës seksuale.⁴⁵
2. Financimi i përshtatshëm nëpërmjet mundësive të përshtatshme të financimit, siç janë grantet afatgjata bazuar në procedura transparente të prokurimit, do të siguronte nivele të qëndrueshme financimi për OJF-të e grave që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara për gratë viktima të dhunës seksuale.⁴⁵
3. Autoritetet kombëtare nxiten fuqimisht që të përgatitin programe dhe grante të përshtatshme, si dhe procedura të përshtatura dhe transparente të prokurimit, për të siguruar nivele të qëndrueshme financimit për OJF-të e grave.

41 Neni 9 i Konventës së Stambollit: *Palët pranojnë, nxisin dhe mbështesin, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile, aktive në luftën e dhunës kundër grave dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata. Neni 18 (4): Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori vepre penale.*

42 Këto rekomandime janë dhënë edhe në raportet bazë të GREVIO-s për Malin e Zi dhe Serbinë.

XII. Komente përmbyllëse dhe rekomandime

Përbledhja ekzekutive përqendrohet te ofrimi i praktikave premtuese të identifikuara në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, por edhe në vende të tjera evropiane, si në Irlandë.

Dokumenti synon të mbështetë politikëbërësit dhe OJF-të e grave kur ngenë dhe drejtojnë shërbime mbështetëse të specializuara për gratë viktima të dhunës seksuale. Për një vështrim më të detauar mbi praktikat e tjera premtuese, lexuesit nxiten të konsultojnë dokumentin e politikave që përbën bazën e përbledhjes ekzekutive aktuale. "Praktikat premtuese të ngritjes dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për gratë që përfjetojnë dhunë seksuale. Një vështrim ligjor dhe praktik për OJF-të e grave dhe politikëbërësit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi."

Siq evidentohet në të gjithë dokumentin, do të ishte thelbësore që të zhvillohet urgjentisht mbështetje e specializuar për viktimat e dhunës seksuale në përputhje me nenin 25 të Konventës së Stambollit në gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ku këto shërbime nuk ekzistojnë.

Sigurimi i një përgjigjeje të ndjeshme nga staf i trajnuar dhe i specializuar, në numër të mjaftueshëm, dhe risjellja në vëmendje se një qendër e tillë duhet të jetë në dispozicion të 200.000 banorëve, janë elemente themelore që duhen marrë në konsideratë kur ngrihen shërbime të tilla, si dhe bërja e tyre të aksesueshme për viktimat në zonat rurale po aq sa edhe në qytete.

Për sa i përket llojit të qendrave, kur vlerësohet nevoja e mundshme për mbështetje në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, mund të ketë nevojë më të madhe për qendra të krizave të përdhunimit sesa për qendra të referimit të dhunës seksuale, duke qenë se të parat ofrojnë ndihmë, këshillim dhe advokim afatgjatë për të mbijetuarat e dhunës seksuale.

Kur autoritetet zgjedhin të ngenë qendra të krizave të përdhunimit ose të referimit të dhunës seksuale, është shumë e rëndësishme që të zhvillojnë mbështetje të specializuar të menjëherëshme, afatshkurtër dhe afatgjatë për këto viktima, e cila ofrohet nga staf me përvjojë i trajnuar posaçërisht në traumën seksuale.

Prandaj, nevojitet të kuptuarit e përbashkët në mbarë rajonin rreth parimeve të punës së këtyre qendrave, duke përfshirë të kuptuarit gjinor të dhunës ndaj grave, respektimin e konfidencialitetit dhe autonominë e të mbijetuarave. Mund të përdoren praktika premtuese nga Mbretëria e Bashkuar, Irlanda dhe vendet nordike, por me përshtatje të kujdeshme ndaj konteksteve kombëtare socio-kulturore.

Vendosja e nevojave të të mbijetuarave në qendër të të gjitha masave mbrojtëse dhe mbështetëse, dhe krijimi i një marrëdhënieje besimi me ata që janë elementë kyç në ngritjen e shërbimeve mbështetëse të specializuara, por edhe në mbështetjen e tyre në sistemin e drejtësisë.

Shërbimet e dhunës seksuale dhe OJF-të e grave ekzistojnë për t'iu shërbyer të mbijetuarave. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e shtetit për të përbushur detyrimet e tij, duke ofruar mbështetjen dhe përgjigjet që të mbijetuarat kanë nevojë dhe gjëzojnë të drejtën për t'i marrë, pa pasur nevojë që të eksposozhen ndaj shtetit. Një nga angazhimet bazë që OJF-të e grave bëjnë ndaj të mbijetuarave është se ato nuk do të vihen në presion apo nuk do të detyrohen të përfshihen me shtetin, dhe se shërbimet dhe mbështetja mund t'iu ofrohen në mënyrë konfidenciale. Së fundi, financimi i përshtatshëm nëpërmjet mundësive të përshtatshme të financimit, siç janë grantet afatgjata bazuar në procedura transparente të prokurimit, do të siguronte financim të qëndrueshëm për OJF-të e grave që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara për gratë viktima të dhunës seksuale.

Duke pasur parasysh se pas luftërave në Ballkanin Perëndimor disa OJF të grave kanë fituar njohuri dhe përvjojë të konsiderueshme në mbështetjen e të mbijetuarave të përdhunimit pas lufte, do të rekomandohej mbështetja te ekspertiza e zhvilluar paraprakisht, e cila pjesërisht ka "humbur" për shkak të fokusit te dhuna në familje në politikat shtetërore në mbarë rajonin. Gjithashtu, mund të organizohen trajnime të specializuara për OJF-të e grave që punojnë tashmë në rajon, bazuar në parimet që janë të njohura ndërkombëtarisht si praktikë premtuese.

Politikat në rajon (p.sh. planet kombëtare të veprimit) përqendrohen kryesisht te dhuna në familje, ndërkohë që duhet të merren në konsideratë të gjitha çështjet e dhunës ndaj grave dhe vajzave, veçanërisht dhuna seksuale. Një hap i rëndësishëm do të ishte forcimi i mbledhjes së të dhënavë dhe hedhja e themelive për politikëbërje të bazuar në evidencia.

Në bazë të raporteve të GREVIO-s (aty ku janë të disponueshme) dhe analizës së raporteve kombëtare, rezultatet e këtij studimi tregojnë më tej se disa vende në rajon (ende) nuk i kanë adoptuar standartet e konventës lidhur me përkufizimin e përdhunimit, veprave të tjera penale të dhunës seksuale, dhe ngacmimit seksual në ligjet e tyre. Ndryshimet ligjore (me gjasë) do të kontribuonin për ndjekje penale më efektive.

Nevojiten ndryshime të konsiderueshme lidhur me zhvillimin e protokolleve dhe udhëzimeve që do të adresonin posaçërisht detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë profesionistëve përkatës në mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale, pasi ato janë të rralla. Nëse ekzistojnë dokumente të tilla, këshillohet që të shqyrtohen dhe rishikohen më tej procedurat pë raportimin e përdhunimit dhe të formave të tjera të dhunës seksuale në rajon.

Nevoja për të zhvilluar protokolle dhe “instrumente” të duhura për profesionistët është edhe më thelbësore nëse kemi parasysh kërkimin mbi qëndrimet ndaj dhunës seksuale të popullsisë së përgjithshme dhe të profesionistëve, që formësojnë perceptimin se çfarë do të thotë dhunë, dhe kontribuon në forcimin e frikës te viktimat për të folur rrëth përvojave të tyre të abuzimit seksual.

Rrjedhimisht, rekomandohet advokimi për ndryshime në rregulloret lidhur me raportimin nga profesionistët, pasi këto bazohen kryesisht në detyrimin strikt të profesionistëve për të raportuar dhunën nëse e zbulojnë atë gjatë punës së tyre. Për më tepër, ka nevojë për të prezantuar masa mbrojtjeje që do të siguronin një balancë të përshtatshme ndërmjet mbrojtjes së viktimave nga njëra anë dhe respektimit të autonomisë së tyre nga ana tjetër, duke u bazuar në standarde e konventës dhe interpretimin e GREVIO-s, të identifikuar në raporte të ndryshme të vlerësimit bazë të GREVIO-s

■



Ky program financohet nga
Bashkimi Evropian

